

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXVI, nr. 8288  
E martë, 28 prill 2026  
Çmimi 0.50 €

## Trumpi mund të fillojë të veshë jelek antiplumb gjatë daljeve publike



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

**AWR** **ABBRUCH** GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KUJT I KONVENOJNË ZGJEDHJET DHE ÇFARË DO TË MUND TË SILLNIN ATO?

FAQE 4-5



Mungesa e kompromisit për presidentin po thëllon krizën politike në Kosovë.

Zgjedhjet e parakohshme duken të mundshme, por pa garanci për zgjidhje. A do të

mund ta zhblokoni ato situatën apo do ta përkeqësonin?

## OPINION

### NJË PRESIDENT NGA BANGLADESHI!

F. 6

Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA



## AKTUALE




### KUVENDI MBAJTI SEANCË TË VEÇANTË PËRKUJTIMORE NË NDERIM TË AKADEMIK REXHEP QOSJES

F. 3

### 27 PRILLI MBETET PLAGË E HAPUR PËR KOSOVËN

F. 5

## EKONOMI



### ÇFARË PO I PENGON INVESTITORËT E HUAJ TË VIJNË NË KOSOVË?

F. 8

### NISËN PUNIMET NË RRUGËN KORISHË - KABASH, LIDHJE ME RRUGËN RAJONALE R-118

F. 8

## SPORT

### DYSHIME PËR KURDISJE TË NDESHJEVE, FFK-ja: VAZHDOJMË TA MBROJMË FUQISHËM INTEGRITETIN E GARAVE

F. 11



### 27 VJET NGA MASAKRA E MEJËS, DËSHMI E KRIMEVE GJENOCIDALE TË FORCAVE SERBE

F. 5



### ORCA: KUVENDI TË MOS VOTOJË NJË PROCES TË KOMPROMETUAR, TË RUHET PAVARËSIA E AGJENCISË SË AKREDITIMIT

F. 7

**RENOVA**  
Maqedoni  
Xhepçishtë - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
PUTZ  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mod: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegjibiznesi.com](http://www.kolegjibiznesi.com)  
info@kolegjibiznesi.com  
038 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## SULMI NË UASHINGTON S'E NDAL FITOREN NDAJ IRANIT, THOTË TRUMPI

UASHINGTON, 27 PRILL - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, ka thënë se një incident me të shtëna në një ngjarje në Uashington, ku ai po merrte pjesë, nuk do ta ndalojë atë nga fitimi i luftës me Iranin. Megjithatë, ai shtoi se nuk beson se incidenti lidhet me konfliktin në Lindjen e Mesme. "Nuk do të më ndalojë nga fitimi i luftës në Iran", tha Trumpi në një konferencë për shtyp natën e 25 prillit, rreth 40 minuta pas të shtënave me armë zjarri në darkën e Shoqatës së Korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë në një hotel në Uashington. "Nuk e di nëse kishte ndonjë lidhje me këtë. Sinqerisht, nuk besoj, bazuar në atë që dimë", tha Trumpi. Trumpi, nënpresidenti JD Vance dhe disa drejtues të kabinetit dhe zyrtarë të tjerë u larguan me

shpejtësi nga agjentët e shërbimit sekret pasi u dëgjuan të shtëna pranë një pike kontrolli jashtë sallës ku Trumpi po përgatitej të mbante fjalim. Zyrtarët thanë se motivet e të dyshuarit nuk dihen ende. I dyshuari u arrestua dhe ndaj tij pritet të ngrihet aktakuzë më 27 prill. Ndërkohë, Trumpi e anuloi të shtunën një udhëtim të planifikuar për në Pakistan nga i dërguari special i ShBA-së, Steve Witkoff, dhe Jared Kushner, për bisedime me Iranin për arritjen e paqes. "Thjesht e anulova udhëtimin e përfaqësuesve të mi që do të shkonin në Islamabad, Pakistan, për t'u takuar me iranianët", tha Trumpi të shtunën mbrëma. "Shumë kohë e humbur nëpër udhëtime, shumë punë! Përveç kësaj, ka përçarje të mëdha dhe

hutum brenda 'udhëheqjes' së tyre", tha Trump. Më pas Trumpi u citua nga Axios duke thënë në një intervistë të shkurtër se anulimi i udhëtimit nuk do të thotë automatikisht rifillim i luftës me Iranin. Në anën tjetër, ministri i Jashtëm i Iranit, Abbas Araqchi, e zhvilloi atë që e quajti "turne në kohën e duhur" në kryeqytetin pakistanez të shtunën, për t'i bashkërenduar "çështjet dypalëshe" me zyrtarët pakistanezë, para se të vazhdonte drejt Omanit dhe Rusisë. Irani e ka kushtëzuar rikthimin në tryezën e bisedimeve me heqjen e bllokadës detare amerikane ndaj porteve iraniane, një kërkesë që Trumpi deri tani e ka hedhur poshtë. Teherani, gjithashtu, e ka hedhur poshtë zgjatjen e



njëanshme të armëpushimit nga Trumpi si "të pakuptimtë" derisa bllokada vazhdon të mbetet në fuqi. Qëkurse ShBA-ja dhe Izraeli nisën bombardimet në Iran më

28 shkurt, zyrtarët amerikanë dhe iranianë kanë mbajtur një raund bisedimesh për paqe, më 11-12 prill në Pakistan, por nuk arritën marrëveshje për përfundimin e luftës.

## TRUMPI MUND TË FILLOJË TË VESHË JELEK ANTIPLUMB GJATË DALJEVE PUBLIKE



UASHINGTON, 27 PRILL - Shtëpia e Bardhë raportohet se po shqyrton masa të reja sigurie për presidentin amerikan Donald Trump, përfshirë përdorimin e mundshëm të një jeleku antiplumb. Ky shqyrtim vjen pas të shtënave të regjistruara në darkën e Korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë. Korrespondenti i "Fox News", Peter Ducey, raportoi se diskutimet janë duke vazhduar në nivelet më të larta rreth mundësisë që Trumpi mund të fillojë të

veshë një jelek antiplumb në paraqitjet e ardhshme publike. Trumpi është përballur tani me tri kërcënime serioze kundër jetës së tij nga po aq sulmues të armatosur, njëri prej të cilëve për pak sa nuk e qëlloi në kokë. Të shtënat me armë zjarri u regjistruan të dielën në darkën vjetore të Shoqatës së Korrespondentëve të Shtëpisë së Bardhë. Darka sapo kishte filluar kur një rrëmujë e madhe u dëgjua në hyrje të sallës.

Të pranishmit menjëherë u shtrinë në dysheme. Presidenti dhe zonja e parë Melania Trump, të cilët ishin ulur në tryezën qendrore në një vend të ngritur përballë mysafirëve, u larguan nga rojet e sigurisë. Agjentët e shërbimit sekret hynë në dhomë të armatosur rëndë. Forcat e sigurisë më pas urdhëruan mysafirët, gazetarë, ministra, politikanë dhe personalitete të ndryshme, të largoheshin nga salla e madhe. Autori i ngjarjes menjëherë u arrestua, ndërsa hetimet vijojnë.

## KORRESPONDENTI I 'THE GUARDIAN' PËRSHKRUAN PANIKUN NË DARKËN E SHTËPISË SË BARDHË: ISHTE SI NJË SKENË NGA HOLLYWOOD-I, POR PO MË NDODHTE MUA

UASHINGTON, 27 PRILL - Korrespondenti i "The Guardian" në Uashington, David Smith, përshkroi momentin dramatik kur një mbrëmje formale u kthye në një skenë terrori në darkën e Trumpit me gazetarët në Uashington. Sipas tij, ndërsa eventin po zhvillohej normalisht, pak pas orës 20:30 u dëgjuan të shtëna. "Bam! Bam! Çfarë ishte ajo? Ku ishte?" kujton ai. Brenda sekondash, salla u përfshi nga paniku dhe konfuzioni. Të ftuarit, të veshur në mënyrë elegante, u hodhën nën tavolina ndërsa dëgjoheshin thirrje si "Uluni poshtë!" dhe "Qëndroni poshtë!". Smithi tha se reagoi instinktivisht, duke u fshehur, ndërsa e përshkroi përvojën si "një skenë nga një film hollivudian, por këtë herë ishte



reale". Agjentët e Shërbimit Sekret Amerikan ndërhyjnë menjëherë me armë në duar, ndërsa disa minuta më vonë presidenti i ShBA-së, Donald Trump, dhe bashkëshortja e tij u

larguan me nxitim nga salla. "Ishim në qendër të ciklonit pa e ditur se çfarë po ndodhte", tha Smith, duke përshkruar pasigurinë që mbizotëronte. Një heshtje e rëndë ra më pas në

sallë, ndërsa forcat e policisë zunë pozicione sigurie. Dëshmitë për numrin e të shtënave ndryshojnë, me disa që flasin për katër dhe të tjerë për pesë. Përfaqësuesi demokrat

Jamie Raskin deklaroi se agjentët e hodhën përtokë për ta mbrojtur: "Njerëzit po bërtisnin dhe ishin shumë të frikësuar", tha ai. Ngjarja ndodhi në një klimë tashmë të tensionuar, ku prania e Trumpit kishte tërhequr vëmendje të madhe dhe debat mbi marrëdhëniet e tij me median. Pas incidentit, eventin u ndërpre dhe presidenti u kthye në Shtëpinë e Bardhë, ku deklaroi se "njerëzit me ndikim janë shpesh në shënjestër", duke iu referuar Abraham Lincoln. Sipas Smithit, incidenti nuk është i izoluar, por pjesë e një rritjeje më të gjerë të dhunës politike në ShBA vitet e fundit. Ironikisht, ngjarja ndodhi në një nga ambientet që konsiderohet më e sigurt në vend, i përforcuar që pas atentatit ndaj Ronald Reagan.

# KUVENDI MBAJTI SEANCË TË VEÇANTË PËRKUJTIMORE NË NDERIM TË AKADEMIK REXHEP QOSJES

EPOKA  
ERE

Qendresa RAMA

PRISHTINË, 27 PRILL - Kuvendi i Kosovës u mblodh në seancë të veçantë përkujtimore në nderim të akademik Rexhep Qosjes i cili ndërroi jetë ditë më parë. Pas nderimit të Kuvendit me një minutë heshtje për figurën, jetën dhe veprimtarinë e akademik Qosjes, kryetarja e Kuvendit, Albulena Haxhiu, mbajti një fjalë rasti.

Haxhiu tha se në këtë seancë përkujtimore Kuvendi i Republikës së Kosovës nderon akademik Rexhep Qosjen si njërin ndër figurat më të shquara që e shndërroi kulturën shqiptare në një hapësirë të mendimit kritik, polemikës, vetëdijes dhe përgjegjësisë historike.

Duke theksuar kontributin e çmuar të akademik Qosjes, kryetarja Haxhiu tha se ai e ndërtoi mendimin e tij mbi vlerat e Rilindjes Kombëtare, mbi trashëgiminë iluministe evropiane si dhe mbi humanizmin dhe figurat që u dhanë shqiptarëve drejtim historik. "Instituti Albanologjik, Universiteti i Prishtinës, letërsia, teatri, filmi dhe debati publik mbajnë në themel punën, guximin dhe praninë e tij. Te Qosja kultura kishte detyrë, libri kishte detyrë dhe intelektual kishte detyrë. Për këtë arsye, vepra e tij doli përtej kufijve të bibliotekës dhe u bë pjesë e historisë politike të Kosovës", nënvizoi kryetarja Haxhiu.

E para e Kuvendit tha se akademik Rexhep Qosja nuk kërkoi nderime për veten, por Republika ka detyrë t'i nderojë ata që, me veprën e tyre, e kanë nderuar shtetin dhe kombën.

Në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës u adresua zëvendëskryeministri Glauk Konjufca.

Duke përmendur kronologjikisht kontributin e çmuar të Qosjes, veçanërisht në letërsi, ai potencoi se akademik Qosja kishte theksuar se vetëdija e konsoliduar kombëtare e ngrë kombin në nivelin e organizimit dhe të sakrificës së nevojshme për të kaluar nga robëria në liri.



Ai gjithashtu vuri në dukje se Qosja ishte një kritik i pakompromis ndaj injorancës dhe arrogancës, ndaj autoritetit të padrejtë dhe pushtetit, si dhe ndaj makutërisë dhe servilizmit. "Qosja nuk është më fizikisht në mesin tonë, por intelektu i tij dhe porosia e madhe që ai la përmes veprës së tij do të vazhdojnë të jetojnë si trashëgimi. Në duart e popullit që ai e deshë aq shumë, kjo trashëgimi do të mbetet një pishtar i pashuar për të ardhmen", tha zëvendëskryeministri Konjufca.

Nga GP i Lëvizjes Vetëvendosje fjalën e mori deputeti Ardian Gola, njëherësh nënkryetar i Kuvendit. Duke theksuar madhësitinë dhe thjeshtësinë e akademik Rexhep Qosjes, Gola u shpreh se me vdekjen e tij ai kalon heshtazi në pronësinë e përhershme të historisë së kombit. Gola shtoi se Qosja ka lënë pas një korpus të pashtershëm intelektual dhe një krijimtari të jashtëzakonshme. "Qosja nuk ishte vetëm njeri i penës, por edhe orator i rrallë, koherent në mendim dhe konfident në artikulum, me leksik të pasur, zë kumbues dhe elokuencë të pashoqe", tha

nënkryetari Gola, duke shtuar se me këtë akt solemn nuk po shënohet fundi i tij, por po vendoset figura e tij në panteonin historik të kombit shqiptar, ku do të shërbejë si busull orientimi për kohët që vijnë.

Në përmbyllje të fjalimit, Gola u shpreh se Rexhep Qosja ishte i domosdoshëm në kohë okupimi, në kohë lirie dhe do të mbetet i domosdoshëm edhe në histori. Nga GP i PDK-së fjalën e mori deputeti Bedri Hamza, i cili tha se me humbjen e Rexhep Qosjes vendi ka humbur një institucion të mendimit kritik, një tribun të fjalës së lirë dhe një ndërgjegje që nuk pranonte të heshte.

Duke çmuar lart veprën e tij, Hamza u shpreh se Qosja ishte kritik për ta ndërtuar të vërtetën. Ai shtoi se nderimi më i madh për akademik Qosjen nuk është vetëm fjala sot, por standardi ynë nesër. "Figura të tilla nuk kërkojnë lavdi, por kërkojnë vazhdimësi", u shpreh deputeti Hamza, duke shtuar se Kosova sot është më e varfër në prani, por më e pasur në trashëgimi. Nga GP i LDK-së u adresua deputetja Jehona Lushaku - Sadriu, duke theksuar se akademik Rexhep Qosja ishte një

intelektual dhe zë i fuqishëm në debatin publik shqiptar, si dhe një ndër kontribuuesit kryesor në zhvillimin e studimeve albanologjike në vend. Ajo u shpreh se me krijimtarinë e tij, Qosja la gjurmë të pashlyeshme në kulturën shqiptare, ndërsa studimet e tij mbi letërsinë shqipe e vendosën në mesin e figurave kyçe të mendimit letrar shqiptar. "Sot nuk kujtojmë vetëm një autor apo një akademik, por një epokë të tërë të mendimit shqiptar. Trashëgimia e tij do të mbetet e gjallë në libra dhe në identitetin dhe ndikimin që ka pasur te brezat", tha deputetja Lushaku-Sadriu.

Nga GP Multietnik fjalën e mori deputeti Erxhan Galushi, i cili tha se Rexhep Qosja i tejkalonte kufijtë e një profesioni të vetëm. Ai ishte studiues i shquar, kritik letrar dhe mendimtar politik që nuk rreshti së angazhuari për të mirën e shoqërisë. Sipas tij, Qosja ishte zë i qartë për lirinë, të drejtat e njeriut dhe dinjitetin kombëtar. Ai shtoi se veprat e tij dëshmojnë se liria është e plotë vetëm kur është e përbashkët dhe se shteti demokratik matet nga mënyra se si i trajton të gjithë qytetarët e tij. "Akademik Rexhep

Qosja ishte shembull i guximit intelektual, i cili nuk u tërhoq përballë vështirësive, nuk heshti dhe nuk ndryshoi qëndrimin për hir të rehatisë", tha deputeti Galushi.

Nga GP i AAK-së fjalën e mori deputeti Besnik Tahiri, i cili e konsideroi akademik Rexhep Qosjen shkencëtar që nuk do të vdesë kurrë, por që bëhet vetëdije e gjallë në ndërgjegjen e një kombi. Ai tha se Qosja do të vazhdojë të jetojë si mendim përtej vetes, duke shtuar se fjala e tij nuk ka qenë tekst, por akt, nuk ishte reflektim i një rrethane, por një qëndrim intelektual. Sipas tij, fjala e Qosjes nuk kërkonte miratim, por kërkonte zgjim dhe përballje me të vërtetën.

Duke përmendur veprat dhe fjalimet e tij, Tahiri u shpreh se krijimtaria e Qosjes nuk prodhoi vetëm estetike, por edhe etikë politike; nuk prodhoi vetëm dije, por edhe ndërgjegje. "Qosja do të mbetet shkrimtari që nuk vdes kurrë", tha Tahiri në fjalën e tij.

Në përmbyllje të seancës u mbajt një minutë heshtje në shenjë nderimi për 27-vjetorin e masakrës në Mejë dhe Korenicë të Gjakovës.

## Certifikohen 44 zyrtarë policorë të Njesisë për Reagim të Shpejtë

PRISHTINË, 27 PRILL - Në Kampin e Njësive Speciale në Vrellë janë certifikuar 44 zyrtarë policorë të Njesisë për Reagim të Shpejtë (NjRSh) pas përfundimit me sukses të trajnimit dyjavor në fushën e "Ballafaqimit me turma".

Trajnimi është realizuar nga instruktorët e Drejtorisë së Njesisë Speciale Operative

(DNjSO) përmes Divizionit të Trajnimeve në kuadër të Departamentit të Burimeve Njerëzore, me fokus në ngritjen e kapaciteteve profesionale për menaxhimin e situatave me turma dhe tubime publike.

Ky aktivitet përbën pjesë të një cikli të planifikuar trajnimesh, i cili do të vazhdojë me

përfshirjen e NjRSh-së në të gjitha tetë rajonet policore, në përputhje me konceptin nacional për menaxhimin e trazirave qytetare.

Policia mbetet e përkushtuar për zhvillimin e vazhdueshëm profesional dhe forcimin e kapaciteteve operative me qëllim garantimin e rendit dhe sigurisë publike.





# KUJT I KONVENOJNË ZGJEDHJET DHE ÇFARË DO TË MUND TË SILLNIN ATO

Mungesa e kompromisit për presidentin po thëllon krizën politike në Kosovë. Zgjedhjet e parakohshme duken të mundshme, por pa garanci për zgjidhje. A do të mund ta zhbllokoni ato situatën apo do ta përkeqësonin?

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Sinjalet që dhanë subjektet kryesore politike në Kosovë nuk paralajmërojnë një kompromis të mundshëm për zgjedhjet e presidentit të vendit deri më 28 prill. Ky është afati kushtetues për zgjidhjen e kësaj çështjeje, në të kundërtën vendi do të shkonte në zgjedhje të parakohshme parlamentare.

## Kujt i leverdisin ato?

Vëzhguesit e zhvillimeve politike konsiderojnë se subjektet politike nuk kanë bërë përpjekje serioze për ta zgjidhur një krizë politike dhe institucionale. Opozita s'i pranoi dy emra të propozuar për president nga partia në pushtet, Lëvizja Vetëvendosje (LV). Partia Demokratike të Kosovës (PDK) dhe Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) refuzuan edhe postin e kryeparlamentarit, të ofruar nga LV-ja, duke e konsideruar joserioze ofertën për kompromis. Analisti Rrahman Paçarizi, profesor i Departamentit të Gazetarisë në Universitetin e Prishtinës, konsideron se,

përgjithësisht, të tri partive po iu konvenojnë zgjedhjet. Sipas tij, LV-ja ka shfaqur gatishmëri për të shkuar në zgjedhje, pasi nuk arriti t'i tejkalonte përplasjet me Vjosa Osmanin, tashmë ish-presidente e vendit, për ta propozuar edhe për një mandat të dytë. Megjithatë, ai konsideron se partia e kryeministrit Albin Kurti nuk e ka pozitën e favorshme njëjtë sikur në zgjedhjet e 28 dhjetorit të vitit të kaluar, kur fitoi mbi 51 për qind të votave. "Mendoj se zgjedhjet më së paku i konvenojnë Lëvizjes Vetëvendosje, sidomos pas çarjes që ka pësuar kjo parti në raport me tashmë ish-presidenten Osmani", shprehet Paçarizi për Radion Evropa e Lirë (REL). LV-ja dhe subjekti politik Guxo, i themeluar nga Osmani, garuan bashkë në një listë zgjedhore në tri palë zgjedhjet fundit. Për njohësin tjetër të çështjeve politike, Agon Maliqi, është e vështirë të përcaktohet se kujt i konvenojnë zgjedhjet aktualisht. Por, edhe ai konsideron se, pas ndarjes me

Osmanin, LV-ja nuk mund ta përsërisë rezultatin e zgjedhjeve të kaluara. "Ndoshta opozita është në një pozitë më të mirë. Pozitat e saj në Kuvend mund të favorizohen më shumë [pas zgjedhjeve eventuale]", thotë Maliqi për REL-in.

## Çfarë do të mund të ndryshonte pas zgjedhjeve eventuale?

Paçarizi konsideron se një gjë është e sigurt: LV-ja nuk do të ishte e gatshme t'i ndryshonte raportet me partitë politike që aktualisht janë në opozitë. Nëse zgjedhjet do të mbaheshin në qershor, dhe nëse partitë politike tash opozitare do të arrinin të ndërtonin një konsensus për bashkëqeverisje, një ndryshim i raportit të forcave në Kuvend do të ishte i mundshëm, mendon ai. "Ndoshta zonja Osmani do të arrijë që t'ia shkëpusë një 5 përqindësh LV-së, një pjesë të atyre që vetë i ka dërguar në Lëvizjen Vetëvendosje në zgjedhjet e vitit 2021. Mirëpo, kjo nuk garanton që do të ketë zgjidhje", thotë Paçarizi. Ai shton se, për të arritur deri te një zgjidhje që nënkupton zgjedhjen e të gjitha institucioneve, përfshirë edhe presidentin, LV-ja do të duhej të binte nën 40 deputetë, ndërsa opozita aktuale të bëhej më e

fuqishme me numra. Në të kundërtën, LV-së do t'i duheshin rreth 70 deputetë që të mund të gjente zgjidhje si e vetme, thotë Paçarizi. Të dy këto opsione, sipas Paçarizit, "në kushtet e tashme janë vështirë të imagjinueshme". Maliqi konsideron se LDK-ja po synon të rikonsolidohet para zgjedhjeve eventuale. Një rikthim i Osmanit në këtë parti mbetet ende i paqartë, ndonëse kreu i LDK-së, Lumir Abdixhiku, e ka lënë derën hapur për të. "Se sa do të përkthehet dalja e Osmanit [nga partneriteti me Kurtin] në ulje të përqindjes së LV-së... ne e kemi parë një herë. Për shembull, në zgjedhjet e shkurtit të vitit të kaluar, kur Osmani ishte në marrëdhënie të acaruara me Kurtin, LV-ja ishte më afër 40 përqindëshit", thekson Maliqi. Ai kujton se në zgjedhjet e fundvitit, votat e qytetarëve që jetojnë në diasporë favorizuan LV-në. Këto vota, sipas tij, do të ishin më të pakta, në rast se zgjedhjet do të mbaheshin në qershor, kur prania e diasporës në vend është më e ulët.

## Si të zgjidhet nyja e krizës politike dhe institucionale?

Analistët nuk besojnë që mozaiku i renditjes së

subjekteve në skenën politike do të ndryshonte në mënyrë substanciale. Për Paçarizin, e vetmja shpresë që të shmangej një bllokadë e sërishme institucionale dhe kushtetuese është që partitë politike ta kuptonin raportin e forcave ndërmjet tyre, si dhe rëndësinë dhe domosdoshmërinë e bashkëpunimit ndërmjet tyre. "Rrugë të tjera nuk ka. Rrugët e tjera janë të rrezikshme për Kosovën... Përndryshe, na presin cikle zgjedhore të pafund", thekson Paçarizi. Të përafërt e ka mendimin edhe Maliqi. Sipas tij, zgjedhjet e parakohshme parlamentare do të mund të sillnin ndryshim përmbajtësor, vetëm në rast se rezultati do të ishte i tillë që LV-ja të mos mund të qeveriste si e vetme. "Pas shumë përpjekjeve, [LV] do të detyrohej të arrinte një lloj kompromisi me të paktën një prej partive... U pa që edhe me 51 për qind, LV-ja ka nevojë për një konsensus, të paktën për postin e presidentit", thekson Maliqi. Ai shton se, në rast se LV-ja do t'i refuzonte kompromiset edhe pas zgjedhjeve eventuale brenda javësh, "një bashkëpunim i opozitës do të imponohej nga rrethanat", në mënyrë që ato të bashkoheshin, të merrnin pushtetin dhe të konsolidonin institucionet.

# 27 VJET NGA MASAKRA E MEJËS, DËSHMI E KRIMEVE GJENOCIDALE TË FORCAVE SERBE

Në Mejë, më 27 prill 1999, forcat shtetërore serbe kryen një ndër masakrat më të mëdha në Kosovë, duke ekzekutuar mizorisht 376 motra e vëllezër shqiptarë të pafajshëm, të dy besimeve fetare. Shumë prej tyre, edhe sot, mbeten të pagjetur

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Ushtruesja e detyrës së presidentes, Albulena Haxhiu, ka bërë homazhe në Mejë. Ajo nga atje ka thënë se 27 vjet më parë, në Mejë dhe në Korenicë të Gjakovës, u krye masakra më e madhe gjatë luftës së fundit në Kosovë. "376 civilë shqiptarë të paarmatosur u vranë ndërsa trupat e tyre, me qëllim fshehjen dhe shkatërrimin e dëshmimeve të krimit, u zhvendosën dhe u rivarrosën, një pjesë e tyre u transportuan për në Serbi. Nderime të përjetshme martirëve të Mejës dhe gjithë Kosovës", ka thënë Haxhiu.

Kryetari i LDK-së, Lumir Abdixhiku, ka thënë se mëngjesin e së hënës e kaloi në Mejë, mes familjarëve që mbajnë ende mbi supë peshën e njëjës nga masakrat më të errëta që kontinenti evropian mban në mend. "Njëzet e shtatë vjet më parë, 376 civilë shqiptarë, mes tyre edhe fëmijë, u ndalën dhe u ndanë me forcë nga më të dashurit e

tyre. U vranë gjakftohtësisht nga forcat policore e ushtarake të Serbisë. Krimi nuk përfundoi aty. Shteti serb organizoi fshehjen e tij. Trupat u bartën 280 kilometra larg, deri në Batajnicë, dhe u varrosën në varre masive. Sot, mes këtyre familjeve, e kupton se koha nuk mbyll gjithçka. Ka dhimbje që mbeten, të qeta në pamje, por të pandryshuara në thelb. Megjithatë, njeriu është më i fortë se guri. Kjo ditë nuk është vetëm kujtim. Është matje me veten. Me atë që kemi kaluar dhe me atë që nuk guxojmë ta harrojmë. Liria e Kosovës është e shtrenjtë. Prandaj kërkon përgjegjësi. Në këtë përgjegjësi Kosova duhet të kërkojë drejtësi për njerëzit e vet dhe një histori që nuk lejohet të harrohet", ka thënë Abdixhiku.

Edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka përkujtuar masakrën e Mejës, duke theksuar se në këtë ditë nderuan kujtimin për martirët e masakrës së Mejës dhe për



dëshmorët e martirët e Skivjanit dhe dëshmorët e Prejlepit. "Në Mejë, më 27 prill 1999, forcat shtetërore serbe kryen një ndër masakrat më të mëdha në Kosovë, duke ekzekutuar mizorisht 376 motra e vëllezër shqiptarë të pafajshëm, të dy besimeve fetare. Shumë prej tyre, edhe sot, mbeten të pagjetur. Plagët e luftës nuk mbyllen pa ndriçimin e fatit të tyre Falë

gjakut të tyre, luftës heroike të Ushtrisë Çlirimtare dhe falë ndihmës së botës së përparuar liridashëse, NATO-s së prirë nga Amerika, ne sot jetojmë të lirë në shtetin tonë. Mirënjohës ndaj sakrificës të të gjithë të rënëve për liri! Pushofshin të qetë në tokën e Kosovës!", ka shkruar Haradinaj në "Facebook". Edhe Partia Demokratike e Kosovës ka kujtuar 376 civilët e

paarmatosur, të masakruar mizorisht nga forcat serbe në Mejë të Gjakovës, më 27 prill të vitit 1999. "Masakra e Mejës është ndër masakrat më të mëdha që janë kryer në Kosovë. Ajo mbetet dëshmi e përhershme e krimeve gjenocidale të forcave serbe në vendin tonë. Kjo masakër tregon qartë se kush ishte viktima e kush agresori", është thënë në njoftimin e PDK-së.

## 27 PRILLI MBETET PLAGË E HAPUR PËR KOSOVËN

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Në shënim të 27 Prillit - Ditës së Personave të Zhdukur me Dhunë Gjatë Luftës në Kosovë, kryeministri Albin Kurti, së bashku me nënën Ferdonije, me familjarë të të pagjeturve, me ministra të kabinetit qeveritar dhe me deputetë të Kuvendit të Kosovës, vendosi kurora me lule të freskëta dhe bëri nderime pranë Monumentit dedikuar personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës.

Me këtë rast, kryeministri Kurti tha se janë edhe 1 565 të pagjetur, ndërsa u bëri thirrje faktorëve ndërkombëtarë që të bëjnë trysni mbi Beogradin zyrtar për zbardhjen e së vërtetës. "Janë edhe njëmbëdhjetë varreza të tjera masive, përveç atyre pesë që tashmë janë zbuluar, e për të cilat Serbia nuk jep informacion, sepse është komunikuar edhe nga vetë ata publikisht se janë 16 varreza masive gjithsej. E vetëm në një ndër prej tyre që është zbuluar, në Batajnicë, i kemi 744 të pagjetur, të zhvarrosur prej atje, ndërkaq gjithsej deri më tani janë rreth 1 000 shqiptarë të cilët janë zbuluar në varrezat masive në Serbi", tha ai.

Në shënimin e Ditës së Personave të Zhdukur me Dhunë, edhe grupi parlamentar i Partisë Demokratike të



Kosovës ka bërë homazhe pranë Monumentit të Personave të Zhdukur në nderim të mijëra qytetarëve të zhdukur gjatë luftës së viteve 1998-1999. "Kërkesa për të vërtetën, për drejtësi dhe për zbardhjen e fatit të mbi 1 600

personave të zhdukur mbetet detyrim moral, kombëtar dhe institucional. Kosova nuk harron!", është thënë në mesazhin e GP të PDK-së. Edhe kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës, Lumir Abdixhiku, përkujton Ditën e të

Zhdukurve me Dhunë në Kosovë. "Sot shënohet Dita e të Zhdukurve me Dhunë në Kosovë nga lufta e viteve 1998-1999, ku makineria kriminale e ushtrisë dhe policisë serbe kreu vrasjen dhe masakrimin e mijëra civilëve shqiptarë të

pafajshëm. Ende edhe sot pas tërë këtyre viteve nuk dihet asgjë për fatin e mbi 1 600 personave të zhdukur nga regjimi i Serbisë. Edhe pas gati një çerekshekulli, familjarët e të zhdukurve presin me ankth për lajme rreth fatit të më të dashurve të tyre. Është obligim yni që jo vetëm sot, por çdo ditë të vazhdojmë e të thërrasim për drejtësi e për zbardhjen e fatit të 1 617 qytetarëve tanë. Kosova, vendi ynë për të cilën dhanë gjithçka burra e gra, pleq e fëmijë, nuk mund të jetë e qetë pa gjetjen e qetësisë së familjarëve që nuk dinë ende për më të dashurit e tyre", ka thënë Abdixhiku.

Edhe ish-presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, ka bërë homazhe pranë Monumentit kushtuar personave të zhdukur me dhunë gjatë luftës. "Familjet ende presin. Disa për një varr. Disa për një përgjigje. Që të gjithë në ankth. Kosova kërkon drejtësi të plotë. Serbia duhet të hapë arkivat dhe të japë llogari për krimet. Mbajtja e të zhdukurve me dhunë dhe fshehja e varrezave masive është krim i përsëritur i Serbisë. E ardhmja ndërtohet vetëm mbi të vërtetën. Paqja e vërtetë ndërtohet vetëm kur ka drejtësi. E vërteta e vetme është se Serbia ende fle mbi varreza masive", ka shkruar Osmani në "Facebook".

# NJË PRESIDENT NGA BANGLADESHI!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

**PATRIOTIZMI I RREMË:** KM i tashëm i Kosovës gjatë 6 viteve të sundimit e jo qeverisjes pati mbështetje si asnjë paraardhës. Kërkoj 50 për qind të votave, së bashku me Vojsa Osmanin dhe i fituan. Për të mos bërë asgjë të mirë për qytetarët e Kosovës dhe vendin. Pastaj ra në 42 për qind dhe provokoi zgjedhje të reja. Kërkonte mbi 50 për qind të votave sepse, sipas këtij autokrati aq i duhen për ta "eliminuar" LS-në dhe krahun e luftës në ndërkohë që LDK-ja e solli në prag të vdekjes klinike. Me ndihmën bujare të Vojsa Osmanit, në atë kohë presidente dhe me shpërdorimin e së paku 300 milionë eurove për blerje të votave i fitoi mbi 51 për qind të votave aq sa edhe kishte kërkuar. Pushteti i tepërt dhe mungesa e vullnetit për të bashkëpunuar me opozitën e lodhur fare e solli në situatë të provokojë zgjedhje të reja duke kërkuar 80 deputetë që i garantojnë pushtet absolut dhe diktaturë "socialdemokrate". Vojsa Osmanin e nxori nga loja shkaku se po merrej me politikë të lartë dhe se ishte afruar me presidentin Trump. Kurthi deklaroi se atij i duhet një president që e luan rolin e zjarrfikësit dhe që ka fobi nga fluturimi me aeroplan! Si Glauku, Albulena apo Fatmirja që kanë mungesë kronike të integritetit dhe që shtyllën kurrizore e kanë aq të lakueshme e që krijohet

përshtypja se as që kanë fare shtyllë kurrizore. Glaukun nuk po ia votojnë ndonjëse sipas Kurthit nuk mundeni të gjeni njeri më të mirë se Glauku .....në Takhikistan! Albulena Haxhiu është u.d. e presidentes kurse Fatmire Mulhaxha, me siguri mund të llogarisë vetëm në votat e Listës Serbe dhe .....Mimoza Kusari, "anëtare nderi" e LS-së. Kurthi si kurthaxhi që është luajti keq dhe poshtër me familjen Jashari. Jo se i vlerëson apo se ka ndonjë respekt për ta por thjesht për arsye se do t'i keqpërdorë si "irone dome" - mburojë e hekurt për Marrëveshjen e Brukselit dhe aneksin e Ohrit me të cilën përligjet federalizimi i Kosovës dhe brutalisht dhunohet karakteri unitar i shtetit. Murat Jashari refuzoi çdo përpjekje të përfshihet në këtë improvizim sa të pamoralshëm aq edhe antikombëtar. Si mund të keni respekt për familjen Jashari dhe UÇK-në kur në qeveri dhe Kuvend keni Hekuran Muratin, Dimal Bashën, Donika Shvarcin, Rozeta Hajdarin, Adriana Matoshin dhe thua 90 për qind të LV-së që mbajnë poste me rëndësi?! Si mund të keni respekt për familjen Jashari kur përfitues permanent të grazilit të Kurthit janë projugosllavët, antikombëtarët dhe armiqtë e UÇK-së si Veton Surroi, Shkëlzen

Gashi, Rronqe Gjinovci, Vudi Gjymshiti me armatën e tyre. Mjafton të dëgjoen prononcimet, intervistat sikur edhe të lexohen punimet "shkencore" dhe hulumtimet për t'u bindur se sa janë kundër familjes Jashari, luftës çlirimtare dhe UÇK-së! Në rastin konkret jam i sigurt se familja Jashari, lufta çlirimtare dhe UÇK-së janë NJË! Të pandashme! Për më keq, neojugosllavët e LV-së përqeshin familjen Jashari dhe e kriminalizojnë luftën çlirimtare dhe UÇK-në. Tash, po këta horra nisin nënshkrimin e peticionit për Murat Jasharin president duke bërë presion ndaj Murat Jasharit dhe familjes Jashari ta pranojnë "edhe këtë sakrificë..". Sepse populli po e kërkon këtë! Kam lexuar disa "letra publike" drejtuar Murat Jasharit nga persona që qençe i kanë shërbyer Jugosllavisë dhe Serbisë kundër nacionalizmit dhe irredentizmit shqiptar. Gjeneratat e reja nuk u njohin këta horra në kohën kur tani janë shndërruar në "ushtarë - zagarë" të Albin Babës. Peticioni për Murat Jasharin president e aktivizuan si armë kundër opozitës pasi, deri më tani dështuan "konsultimet" për president. LV-ja e ka llogaritur që nëse emri i Murat Jasharit do të silltet në Kuvend për votim, deputetët e krahut të luftës do e votojnë prandaj Kurthi po e

keqpërdorë këtë kartë emocionale. Kurthi, me cyber zagarët po luan gjithashtu duke përdorur si xhoker fajësimin e opozitës për zgjedhje të parakohshme eventuale.

**Akuzat nuk qëndrojnë (huazim nga gjenerali Clark):** Edhe nëse shkohet në zgjedhje të parakohshme, opozita nuk ka asnjë përgjegjësi aq më parë se në çdo vend normal opozita e ka detyrim ta çojë vendin në zgjedhje sidomos në Kosovë ku kemi një qeveri kleptokratike (të hajnave), antikombëtare, të paaftë profesionalisht dhe krejtësisht klienteliste. Opozita nuk duhet fare të ndikohet nga këto akuza fajësuese kur përgjegjësia i takon mazhorancës absolute. Nëse do të kemi zgjedhje të parakohshme LDK-ja bashkë me shkatërruesen e dikurshme të kësaj partie, Vojsa Osmanin do të ketë rritje të ndjeshme. PDK-ja do të mbetet atypari, AAK-ja nuk do të merr fare në thua në pragun zgjedhor. NISMA dhe PSD, nëse bashkohen mund të kacavirren për pragu. LV-ja do të tkurret, sa, sot nuk mund të parashikohet. Mënyra e të bërit opozitë do të ndikojë në rezultatin e zgjedhjeve, pa asnjë dyshim. Nëse opozita bien në kurthin e Kurthit duke u lëshuar në një fjalorë fyes dhe përjashtues, do të ndahet keq! LV-ja dhe Kurthi janë nëna dhe baba

e rrugaçerisë institucionale, në këtë fushë shkëlqejnë. Janë të paarrtshëm! Opozita ka njëqindmijë fakte me e xhveshë këtë qeveri të paaftë, pa pasur nevojë të përdorë fjalë të forta. Për këtë më vonë nëse do të mbahen zgjedhjet.

Deri më tani si model të të bërit opozitë në aspektin politik dhe ekonomik janë zonjat Hykmete Bajrami dhe Janina Ymeri si dhe Ramush Haradinaj. Ermal Sadiku nëse i reziston centrifugës për zbutje (joshjes me ndonjë post klientelist), mund të bëhet opozitar i jashtëzakonshëm. Te mediat flamurin e ka Lirim Mehmetaj. PDK-ja ka bërë opozitarizëm kushtetues. Një qeveri dhe një KM, kushdo qofshin ata, nëse me 51 për qind të votave nuk sigurojnë qëndrueshmëri institucionale, nuk janë as për Shtime, thënë më së buti.

LV-së dhe Kurthit nuk i përshtaten zgjedhjet aq më parë që SPAK-u kosovar më nuk është vetëm embrion. Po rritet, dita - ditës.

**Nisma e re e Halil Kastriotit:** Halil Kastrioti është humanist i madh, është Baba i Jetimëve të Ballkanit. Buzë kutive për Jetimët e Ballkanit do ta vendosë një kuti: Ndihmë për Albin Babën. Slogani është: dhuroni sa të keni mundësi se për bukë e kam, xhipa të blinduar kam. Jo reperi 50 cent por Albini me 16 euro!

## FSK-ja e dërgon një ekip në Gazë për vlerësimin e vendit ku do të veprojë si pjesë e misionit paqeruajtës

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Kosova e ka dërguar një ekip të Forcës së saj të Sigurisë (FSK) në Rripin e Gazës për të bërë një vlerësim të vendit ku pritet të veprojë trupat e Kosovës si pjesë e një force ndërkombëtare në territorin palestinez, njoftoi FSK të dielën. Kuvendi i Kosovës e miratoi me shumicë votash më 17 prill vendimin e mëparshëm të Qeverisë për të dërguar trupa në Forcën Ndërkombëtare Stabilizuese (FNS) si pjesë e nismës së mbështetur nga Shtetet e Bashkuara pas armëpushimit midis Izraelit dhe Hamasit vitin e kaluar. Hamasi është grup militant i shpallur terrorist nga ShBA dhe Bashkimi Evropian. "Komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletenant Bashkim

Jashari, ka dërguar një ekip të FSK-së në Gazë për të realizuar rikonicionin e zonës ku do të operojnë trupat e FSK-së", thuhet në një njoftim të FSK-së. Ekipi do të bëjë vlerësime paraprake dhe bashkërendim të aktiviteteve lidhur me zhvendosjen e trupave të FSK-së, të cilat do të veprojë brenda misionit paqeruajtës të FNS-së, e cila është mekanizëm i themeluar si pjesë e nismës së ashtuquajtur Bordin e Paqes nga presidenti amerikan, Donald Trump, për arritjen e paqes në botë. FSK-ja në njoftimin e saj në "Facebook" nuk tregoi se kur ka udhëtuar ekipi për në Gazë, e as se sa kohë do të zgjasë vlerësimi i terrenit. Forca Ndërkombëtare Stabilizuese nuk është vendosur në Gazë ende për të ndihmuar

në ruajtjen e paqes si dhe për rindërtimin e territorit të rrënuar palestinez, në përputhje me Bordin e Paqes. Sipas raportimeve të transmetuesit publik izraelit KAN, misioni pritet të nisë angazhimin në Gazë nga muaji maj, përfshirë edhe dhjetëra ushtarë nga Kosova, megjithëse institucionet në Prishtinë nuk e kanë konfirmuar zyrtarisht këtë afat. Kosova është në mesin e pesë shteteve të para - së bashku me Indonezinë, Marokun, Kazakistanin dhe Shqipërinë - që janë zotuar për angazhim në këtë mision. Ministri i Mbrojtjes i Kosovës, Ejup Maqedonci, ka thënë më herët se kontingjenti i Kosovës do të përbëhet nga disa dhjetëra oficerë, përfshirë edhe njësi për çminim. Sipas tij, trupat do të



kenë detyra për ofrimin e ndihmës humanitare, asistencë në siguri dhe detyra të tjera të përcaktuara nga mandati i forcës për Gazën. Përveç autorizimit për dërgimin e trupave, Kuvendi duhet të

miratojë edhe marrëveshjen për anëtarësimin e Kosovës në Bordin e Paqes. FSK-ja ka rreth 4 000 pjesëtarë dhe është në proces të shndërrimit në ushtri të plotë profesionale deri në vitin 2028.

## JELLENA GJUKANOVIQ DËNOHET ME GJASHTË VJET BURGIM PËR SPIUNAZH

PRISHTINË, 27 PRILL - Gjykata Themelore në Prishtinë është dënuar me gjashtë vjet burgim Jellena Gjukanoviçit për akuzën e spiunazhit. Gjukanoviçi ishte e pranishme në gjykatore në shpalljen e aktgjykimit ndaj saj. Jellena Gjukanoviç u arrestua në shkurt të vitit 2025 dhe aktakuza ndaj saj u ngrit në shtator të po atij viti. Ajo e ka mohuar fajësinë, teksa Prokuroria Speciale e Kosovës në fjalën përfundimtare të mbajtur javën e kaluar kërkoi dënim prej 25 vjetësh burgim. Gjukanoviç, nga Mitrovica e Veriut, punonjëse e Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (OSBE), u arrestua më 28 shkurt në pikën kufitare të Jarinjës, në veri të Kosovës, dhe

prej asaj kohe ndodhet në paraburgim. Gjykimi ndaj saj nisi më 16 shtator të vitit të kaluar. Në aktakuzë thuhet se ajo ka transmetuar informacione tek Agjencia Serbe e Sigurisë dhe Inteligjencës (BIA), ka rrezikuar rendin kushtetues dhe sigurinë kombëtare të Kosovës. Prokurori special, Bekim Kodraliu, gjatë gjykimit ka thënë se Gjukanoviçi kishte qenë në kontakt me dy zyrtarë të BIA-s: Ratko Gajtani, përgjegjës i agjencisë në rajonin e Novi Pazarit, dhe Lubisha Bukviç, zyrtar tjetër i saj. “Me këtë të fundit, e pandehura është takuar disa herë në zyrat e BIA-s në Beograd”, ka deklaruar ai. Sipas Kodraliut,



Gjukanoviçi ka shfrytëzuar pozitën që mbante në OSBE, duke vepruar nën ndikimin e Aleksandar Vllajiqit, i dënuar tashmë për spiunazh, si dhe zyrtarëve të tjerë të BIA-s. Prokuroria ka thënë se

Gjukanoviçi ka kontribuar në krijimin e një “narrativi armiqësor” ndaj institucioneve të sigurisë, shtetësisë dhe integritetit territorial të Republikës së Kosovës. Përmes këtyre veprimeve të

qëllimshme, sipas Prokurorisë Speciale, Gjukanoviçi ka vënë në rrezik serioz jetën dhe sigurinë personale të zyrtarëve shtetërorë, qytetarëve të vendit dhe personelit ndërkombëtar të OSBE-së në Kosovë.

Sipas Kodit Penal të Kosovës, spiunazhi është vepër e rëndë penale dhe dënohet me të paktën pesë vjet burg, nëse vërtetohet fajësia.

Së voni autoritetet në Kosovë kanë arrestuar disa persona, shqiptarë dhe serbë, nën dyshimet për spiunim në shërbim të inteligjencës serbe. Ekspertët kanë thënë se këto raste tregojnë se spiunazhi mbetet një kërcënim serioz për sigurinë e Kosovës.

## ORCA: KUVENDI TË MOS VOTOJË NJË PROCES TË KOMPROMETUAR, TË RUHET PAVARËSIA E AGJENCISË SË AKREDITIMIT

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 27 PRILL - Organizata për Rritjen e Cilësisë në Arsim (ORCA) ka zhvilluar të hënën një aksion simbolik para objektit të Kuvendit të Kosovës, duke kundërshtuar, siç u tha, tentimet për cenimin e pavarësisë së Agjencisë së Kosovës për Akreditim. “Më 7 prill 2026 Ministria e Arsimit shpalli thirrjen publike për nominimin e tre anëtarëve vendorë në Këshillin Shtetëror të Cilësisë, me afat aplikimi prej 8 ditësh. Për këtë thirrje aplikuan gjithsej 10 kandidatë. Më 20 prill komisioni vlerësues u mbledh për shqyrtimin e aplikimeve dhe brenda rreth 48 orëve përfundoi vlerësimin e të gjithë kandidatëve, duke hartuar listën e rekomandimeve, të cilën ia dorëzoi ministrit Hajrullah Çeku. Në fushën e mjekësisë u rekomandua Driton Vela. Raporti i komisionit është proceduar në qeveri në mënyrë urgjente, pa qartësi nëse është nënshkruar nga të gjithë anëtarët, ndërsa kandidatët e refuzuar nuk kanë marrë njoftime zyrtare dhe nuk



është respektuar afati ligjor për ankimim. Kjo mënyrë e procedimit ngre dyshime serioze për integritetin e gjithë procesit”, tha aktivisti i ORCA-s, Dibran Hoxha, duke shtuar se një nga arsyt kryesore të përdorura për ta justifikuar këtë procedurë është pretendimi për mungesë kuorumi në Këshillin Shtetëror të Cilësisë. Megjithatë, përbërja aktuale e këtij organi garanton funksionimin e tij edhe për një periudhë të konsiderueshme kohore. Rrjedhimisht, nuk ekziston asnjë bazë faktike apo ligjore për të krijuar urgjencë për ndërhyrje në përbërjen e tij”, tha

Hoxha. Ai ka pohuar se në këtë proces është rikthyer edhe emri i Driton Velës, ish-kandidat për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje në zgjedhjet parlamentare të vitit 2019. “Driton Vela në vitin 2023 ishte diskualifikuar nga një proces i ngjashëm për shkak të deklarimeve të pasakta në aplikim, konkretisht për pretendimin se kishte rol akademik si bartës i programit në Universitetin e Prishtinës dhe për paraqitje të pasakta të përvojës së tij akademike. Në tetor të vitit 2025 ai u përfshi në

një incident publik me sjellje joakademike gjatë një mbledhjeje të Këshillit të Fakultetit të Mjekësisë, ndërsa në shkurt të vitit 2026 i është shqiptuar vërejtje me shkrim nga Universiteti i Prishtinës për cenim të imazhit institucional. Pavarësisht këtij historiku, ai është rekomanduar sërish për një pozitë vendimarrëse në këtë institucion”, tha ai.

Ai ka kujtuar se katërmëdhjetë organizata të shoqërisë civile dhe rrjeti ROSCAP kanë kërkuar ndalimin e procesit dhe refuzimin e listës, duke paralajmëruar për pasoja në kredibilitetin e Agjencisë dhe në pozicionin e saj në mekanizmat ndërkombëtarë të sigurimit të cilësisë. “Ky rast tregon qartë se si një proces që duhet të bazohet në meritë dhe transparencë mund të shndërrohet në një procedurë të përshpejtuar, ku standardet relativizohen dhe kriteret anashkalohen. Nëse kjo logjikë pranohet, atëherë përzgjedhja e anëtarëve të një institucioni të pavarur pushon së qeni proces profesional dhe shndërrohet në vendimarrje të orientuar nga interesa të tjera.

Për këtë arsye, ORCA kërkon që ky proces të anulohet dhe të iniciohet një procedurë e re, transparente dhe e bazuar në meritë. Çdo vendim që cenon pavarësinë dhe kredibilitetin e Agjencisë së Kosovës për Akreditim rrezikon drejtpërdrejt edhe pozitën ndërkombëtare të sistemit të arsimit të lartë në vend, përfshirë anëtarësimin në mekanizma si EQAR dhe ENQA. Prandaj, u bëjmë thirrje deputetëve të Kuvendit të Republikës së Kosovës që, në ushtrimin e mandatit të tyre për ta mbrojtur interesin e qytetarëve dhe interesin shtetëror, që përfshin edhe ruajtjen e pavarësisë dhe integritetit të institucioneve të pavarura, të mos i votojnë këta emra në seancën e sotme. Ky proces nuk i plotëson standardet minimale të transparencës, meritës dhe ligjshmërisë dhe, si i tillë, duhet të refuzohet, duke hapur rrugë për një procedurë të re, të drejtë dhe të besueshme. Në të kundërtën, ata do të bëhen bashkëpjesëmarrës në cenimin e pavarësisë dhe kredibilitetit të Agjencisë së Kosovës për Akreditim”, tha Hoxha.

## BE-ja shpreh keqardhje që Serbia nuk i ka ndjekur ende përgjegjësit e sulmit në Banjskë

Prishtinë, 27 prill - Bashkimi Evropian i ka thënë të hënën Radios Evropa e Lirë se shpreh keqardhje që Serbia nuk i ka marrë ende hapat e nevojshëm për t'i përballur me drejtësinë përgjegjësit për sulmin në fshatin Banjskë të Kosovës në vitin 2023. Një zëdhënës i BE-së i ka bërë këto deklarata teksa e ka komentuar vendimin e Gjykatës Themelore në Prishtinë, e cila më 24 prill i ka dënuar tre të akuzuarit për sulmin: Bllagoje Spasojeviçin dhe Vladimir Tolliçin me burgim të

përjetshëm, ndërsa Dushan Maksimoviçin me 30 vjet burgim. Sulmi në Banjskë ndodhi më 24 shtator 2023 si pasojë e të cilit u vra rreshteri i Policisë së Kosovës, Afrim Bunjaku. Në këmbim e sipër të të shtënave u vranë edhe tre sulmues serbë. Millan Radoiçiq, atëbotë nënkryetar i Listës Serbe - partisë më të madhe të serbëve në Kosovë, e cila gëzon mbështetjen e Beogradit zyrtar - mori përgjegjësinë për sulmin. Tre të dënuarit kanë qenë pjesë e

grupit prej 45 personash ndaj të cilëve kanë ngritur aktakuzë autoritetet e Kosovës, përfshirë Radoiçiqin. Përveç tre të dënuarve, pjesa tjetër e të akuzuarve janë në arrati. Për autoritetet e Kosovës Radoiçiqi ka qenë “udhëheqësi i grupit terrorist” dhe sulmi është organizuar nga shteti i Serbisë. Beogradi, në anën tjetër, i hedh poshtë këto akuzat. Autoritetet në Kosovë i kanë ndarë procedurat penale kundër Spasojeviçit, Tolliçit dhe Maksimoviçit, të cilët ndodheshin në paraburgim që



nga shtatori 2023, ndërsa e kanë hedhur poshtë kërkesën e Prokurorisë Speciale për një gjykim në mungesë për 42 të pandehurit e tjerë. Institucionet e Bashkimit Evropian u kanë bërë thirrje rregullisht autoriteteve të Beogradit që ta përcaktojnë

përgjegjësinë për sulmin dhe t'i nxjerrin përgjegjësit para drejtësisë. Megjithatë, pavarësisht prej thirrjeve nga blloku evropian, Shtetet e Bashkuara dhe NATO-ja, autoritetet në Serbi nuk kanë ngritur asnjë aktakuzë, madje as ndaj Radoiçiqit i cili besohet se është në Beograd. Gjykata e Lartë në Beograd ka bërë me dije se ekziston vendimi që ia ndalon Radoiçiqit largimin nga banesa e tij dhe ka detyrim të paraqitet në polici, ndërsa Zyra e Prokurorit nuk e ka komentuar ndonjë aktakuzë eventuale.

## Nisën punimet në rrugën Korishë - Kabash, lidhje me rrugën rajonale R-118

PRISHTINË, 27 PRILL - Kanë nisur punimet në projektin rrugor Korishë - Kabash, në gjatësi prej 6.7 kilometrash, që krijon lidhje me rrugën rajonale R-118 dhe përforcon lidhjen e kësaj zone me pjesët e tjera të rajonit të Prizrenit.

Në ceremoninë e nisjes morën pjesë kryeministri i Republikës së Kosovës, Albin Kurti, ministri i Infrastrukturës, Dimal Basha, deputetët Artan Abrashi dhe Arbër Rexhaj, si dhe aktivistë e qytetarë. Ky projekt, me vlerë prej 4.1

milionë eurosh, financohet plotësisht nga Qeveria e Republikës së Kosovës dhe është hap konkret drejt përmirësimit të infrastrukturës dhe qasjes për banorët e kësaj zone. Përmes këtij investimi synohet lidhja më e mirë e kësaj ane me

rrjetin rrugor, duke krijuar kushte më të favorshme për zhvillim ekonomik dhe turistik. Bukuritë natyrore të kësaj zone, të kombinuara me këtë investim, pritet ta rrisin potencialin dhe atraktivitetin e saj.



## ÇFARË PO I PENGON INVESTITORËT E HUAJ TË VIJNË NË KOSOVË?

PRISHTINË, 27 PRILL - Kosovës i duhet stabilitet politik për të tërhequr më shumë investime të huaja, vlerëson Emrush Ujkani, drejtor ekzekutiv në Këshillin e Investitorëve Evropianë. Sipas tij, një rol të rëndësishëm në këtë proces luan edhe mënyra se si të huajt e perceptojnë imazhin politik dhe nivelin e sigurisë në vend.

Në podkastin 5 pyetje të Radios Evropa e Lirë, Ujkani thotë se kjo është gjëja e parë që investitorët pyesin kur synojnë Kosovën për të investuar. "Njerëzit, para se ta dinë se cili është ligji, para se të dinë se çfarë burokracie ka, ata duhet ta dinë ku është kjo hartë, çfarë ka dhe çfarë nuk ka aty, se si funksionon si shoqëri dhe si shtet", shprehet ai.

Duke folur se pse një investitor i huaj zgjedh Shqipërinë apo Maqedoninë e Veriut para Kosovës për të hapur një

fabrikë, ai sqaron se këto dy shtete qëndrojnë më mirë në aspektin e procedurave për ta marrë në shfrytëzim një pronë publike.

Kjo, në Kosovë, sipas tij, nuk është qartë e definuar dhe përbën pengesë për ta. "Niveli i burokracisë që haset në vendin tonë vlerësoj se është i ekzagjeruar", thotë Ujkani për REL-in, teksa sqaron se Kosova duhet t'i shkurtojë afatet ligjore të procedurave për investim në krahasim me vendet të rajonit që Kosova të shihet opSIONI për të investuar. "Para se të dinë se cili është ligji, para se të dinë se çfarë burokracie ka, ata duhet ta dinë ku është kjo hartë, çfarë ka dhe çfarë nuk ka aty, se si funksionon si shoqëri dhe si shtet", shprehet ai. "Pse duhet ta mendojë një investitor potencial se a është një çështje, ta zëmë, në



kompetencë të komunës së Prishtinës apo të Ministrisë së Tregtisë", shprehet ai. Sa iu përket remitencave nga diaspora, të cilat gjatë vitit 2025 arritën shifrën e 1.4 miliard

eurove, Ujkani thekson se institucionet duhet të komunikojnë me mërgatën, që fokusi i atyre mjeteve të orientohet në investime produktive, që hapin vende të

reja pune. Megjithatë, sipas tij, edhe si të tilla, duke u shpenzuar për pasuri të paluajtshme nga mërgata, kanë efektin e tyre jo të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të Kosovës.

## SHËNOHET DITA E PRONËSISË INTELEKTUALE, NË FOKUS SPORTI DHE INOVACIONI



PRISHTINË, 27 PRILL - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë, Tregtisë dhe Inovacionit, ka shënuar Ditën Botërore të Pronësisë Intellektuale me moton "Pronësia intelektuale dhe sporti - ready, set, innovate".

Ministria e MINTI-it, Mimoza Kusari-Lila, tha se mbrojtja e markave tregtare, patentave dhe dizajneve industriale u mundëson bizneseve dhe organizatave ta sigurojnë identitetin e tyre dhe ta zhvillojnë aktivitetin në mënyrë të qëndrueshme.

Ajo vuri në pah edhe përparimet e Agjencisë për Pronësi Industriale në përmirësimin e shërbimeve dhe rritjen e efikasitetit të procedurave, duke lehtësuar qasjen për bizneset

dhe qytetarët.

Në veçanti u theksua rëndësia e mbrojtjes së markave tregtare në sektorin e sportit, si një element kyç për ndërtimin e identitetit, besueshmërisë dhe zhvillimit komercial të klubeve sportive.

Ministria Kusari-Lila theksoi se ministria mbetet e përkushtuar për forcimin e sistemit të pronësisë intelektuale dhe krijimin e një mjedisi të favorshëm për inovacion dhe ndërmarrësi.

Në shënimin e Ditës Botërore të Pronësisë Intellektuale morën pjesë edhe zëvendësministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Nora Arapi Krasniqi, si dhe drejtori i përgjithshëm i Doganës së Kosovës, Agron Llugaliu.

## Deputetja e LDK-së: Rryma në veri, më e lirë se në pjesën tjetër të Kosovës

PRISHTINË, 27 PRILL - Deputetja e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Janina Ymeri, ka deklaruar se në Kosovë ekzistojnë dallime në çmimin e energjisë elektrike mes komunave në veri dhe pjesës

tjetër të vendit. Në një reagim publik ajo ka thënë se "në Kosovë, nën pushtetin 'cep m'cep', nëse je në komunat veriore, rryma, gjegjësisht tarifa është deri në 18.3% më lirë sesa në pjesën ku jetojmë ne, me

shumicë kosovare". Ymeri ka shtuar se "çdo faturë që e keni në shtëpi do të ishte më e lirë në Mitrovicën e Veriut dhe komunat e tjera ku operon 'ElektroSeveri' brenda territorit të vendit".

Ajo, gjithashtu, ka pretenduar se qytetarët në pjesët e tjera të Kosovës mbajnë barrë shtesë, duke deklaruar se "ne paguajmë edhe shpenzime operative të KEDS-it për komunat veriore të Kosovës".



SHTYPI EVROPIAN PËR NGJARJET E PRANVERËS TË VITIT 1981 NË KOSOVË

# “MË 27 PRILL, VIKTOR MAYER NGA VJENA SHKRUAN: ‘NË DEMONSTRATAT NË KOSOVË KA TË VRARË E TË PLAGOSUR, NJË PJESË E FUNKSIONARËVE JUGOSLLAVË KANË...”

Nga Ibish NEZIRI

Si arriti media gjermane të përçojë në terrin e madh informativ lajmet për Kosovën në vitin 1981? Autori bën një vështrim të kujdesshëm të një historie të madhe, e cila sot po tretet në morinë e lajmeve bosh të ditës. Autori me shumë kujdes e përshkruan situatën në Kosovë në vitin 1981 në shkrimin e tij, të titulluar: “KOSOVA DHE SHQIPTARËT NË SHTYPIN GJERMANFOLËS TË VITIT 1981”. Nuk mundohet të mbaj anë, por bën punën e një kronikani të mirë, që do t’u vlejë shumë atyre që do të merren me argumentin më vonë...! Nga fillimi i demonstratave në Kosovë e deri në fund të vitit kjo revistë ka botuar 7 artikuj për Kosovën dhe shqiptarët.

Më 5 maj botohet shkrimi me titull “Jugosllavia – Pa pantallona të përvjelë”, në të cilin ndër të tjera thuhet se “pas vendosjes me dhunë të paqes në Kosovë, partia i rregullon radhët: armiq në çdo anë”. Në shkrim gjithsesi ka histori.

Autori sjell fakte, të cilat e qartësojnë fare mirë se Kosova ka qenë dhe është e pushtuar, pastaj flitet për zhvillimet gjatë periudhave të ndryshme të pasluftës së Dytë Botërore, për emigracionin shqiptar në Evropë dhe Amerikë, në Belgjikë e SHBA-ës, për marrëdhëniet e Shqipërisë me Jugosllavinë dhe sidomos me Kosovën, të cilat udhëheqësit partiakë e shtetërorë të Jugosllavisë dhe Kosovës i shohin si të gabueshme, për marrëdhëniet e tendosura jugosllavo-shqiptare, për demonstratat dhe pasojat e tyre, për të vrarë, të plagosur e të arrestuar.

Më 18 maj “Der Spiegel” e boton shkrimin me titull “Barinj idealë”. Autori qysh në fillim thotë: “Pas thyerjes së kryengritjes në Kosovë, Beogradi dëshiron ta qetësojë Kroacinë përmes arrestimesh”. Periudha mes majit dhe tetorit kalon pa ndonjë shkrim për Kosovën. Më 12 tetor botohet një shkrim me titull: “Të gjithë heshtin”; “Beogradi nuk mund t’i fus nën kontroll trazirat në Kosovë. Qe shtatë muaj atje rebelohen banorët shqiptarë”.

Në shkrim flitet për trazira, greva, sabotim, vështrësi ekonomike etj. “Shtrohet pyetja se kudo në centralet energjetike dihet se ku qëndrojnë defektet dhe pse ka defekte, ndërkaq në ato të Kosovës nuk dihen. Shqiptarët po rebelohen. Në vend të 2.4 milionë



KW energji elektrike, tani mezi i dërgohen Serbisë më pak se një milion.

Shefi i Sigurimit Shtetëror në Ferizaj, Milorad Stanković, rebelimin, mungesën e rrymës dhe grevat i vë në lidhje me nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar. Ai thotë: “Veprimtaria e nacionalistëve dhe irredentistëve shqiptarë nuk tregon shenja dobësimi. Armiku tani po organizohet në grupe dyshe dhe treshe. Ata në parullat dhe pamfletet e tyre po thërrasin për diversione dhe vënie zjarri”. Më tutje flitet për një sabotim në Fabrikën e Duhanit në Gjilan.

Për këtë thuhet se; “të gjithë i dënojnë këto veprime, por të gjithë heshtin. Askush nuk tregon gjë. “Fabrikat po i kaplon flaka. Shtëpia e një funksionari të Sigurimit është infektuar. Gazetat njoftojnë për një sukses: Është penguar kallja e veturës së një funksionari, por sulmuesit janë zhdukur në errësirë.

Vetëm me trimëri të jashtëzakonshme dhe gjakftohësi lokomotivistët e talentuar pranojnë të udhëtojnë natën në hapësirën e Kosovës. Mbi binarë gjenden gurë. Aparaturat sinjalizuese janë shkatërruar. Predha të rrezikshme për jetë i godasin xhamat e përparme të trenave.

Gjithashtu ushtarët e ardhur për përforcim nga anë tjera të vendit sulmohen e lëndohen”.

“Der Spiegel” thotë se për “Politika Express-in” e Beogradit është e qartë: Kundërrevolucionarët kanë forcë të mos i dorëzojnë armët. Armiqtë e ndryshojnë taktikën e veprimtaria. Ata, nga veprimtaria e hapur kalojnë në veprimtari të fshehtë. Për gazetën “Narodna Armija”, sipas “Der Spiegel”, edhe djegiet e pyjeve janë vepër e armikut. “Ne gjendemi në luftë”, citon autori gazetën “Narodna Armija”.

Në këtë shkrim tutje thuhet se ende popullit të Jugosllavisë nuk i është thënë ajo që ka ndodhur në Kosovë. Kosova jo vetëm që ka qenë e ndaluar për muaj të tërë për gazetaret e huaj, por ajo ka qenë e ndaluar edhe për vendorët. Në të kanë mundur të shkojnë vetëm gazetarët e besueshëm partiakë. Të dhënat për të vrarë e të plagosur, të botuara në shtyp, e kanë përjashtuar njëra-tjetrën” Revistës “Der Spiegel” tani nga Kosova i vjen një thirrje për ndërgjegjen e gjithë botës së civilizuar, të nënshkruar nga tre profesorë universitarë: “Gjatë muajt mars dhe prill në të dy rrugët kryesore të Prishtinës, ‘Ramiz Sadiku’ dhe ‘Marshall

Tito’ ka pasur skena të tmerrshme: kufoma të shtrira, shpesh të ndara dhe të copëtuara, pa koka, këmbë dhe duar.

Mes të vdekurve gjithashtu edhe fëmijë të moshës shkollore. Këto kanë qenë gjurmët e fundit të masakrave të kryera nga ushtria dhe milicia jugosllave. Shumë kufoma janë bartur me kamionë ushtarakë dhe janë djegur jashtë qytetit me kerozinë”.

Mundësia për t’i vërtetuar këto të dhëna nuk ekziston, sepse si thonë apeluesit, emrat e të cilëve janë të njohur për redaksinë, është e vërtetë se Qeveria e ka shpallur gjendjen ushtarake në gjithë hapësirën e Kosovës: Amnistia Internacionale dhe Kryqi i Kuq Ndërkombëtar nuk mund të shkojnë në Kosovë”.

Tre informatorët raportojnë më tutje se pakica shqiptare në Jugosllavi nuk është në gjendje për ta raportuar drejtpërdrejt në botën e jashtme për gjendjen. “Raportet zyrtare flasin vetëm për imazhe të zbehta të masakrave që kanë ndodhur në krahinën tonë fatkeqe. Të drejtat qytetare nuk vlejnjë më. Natën nëpër rrugë patrollojnë ushtarët legionarë që mund ta arrestojnë secilin. Ne nuk mund t’i vlerësojmë, por kjo ka të bëjë me më shumë se një mijë të

arrestuar”.

Sipas të dhënave të gazetave beogradase, më shumë se 2000 shqiptarë janë dënuar pa gjyq dhe pa mbrojtje. Deri me 31 gusht janë dënuar 245 persona me dënime burgu deri 15 vjet. Në fillim të shtatorit janë dhënë edhe 50 vendime gjyqi me një dënim mesatar prej 9 vjetësh”.

“Süddeutsche Zeitung”, një gazetë tjetër gjermane me shumë renome, i përcolli zhvillimet në Kosovë, rreth Kosovës dhe shqiptarëve me shumë interesim, duke filluar ashtu si edhe gazetat tjera me informatat e lëshuara nga “Tanjugu” për demonstratat e 11 Marsit.

Shkrimi i parë për Kosovën e vitit 1981 në këtë gazetë, botohet në numrin e datës 14/15 mars, në të cilin njoftohet për fillimin e protestave në Prishtinë, si lajm shumë i shkurtër. “Problemet e Beogradit me Kosovën rriten”, është një shkrim relativisht i gjatë, të cilin kjo gazetë e sjell pas demonstratave të 26 e 27 marsit. Shkrimi botohet më datën 30 mars nga korrespondenti i kësaj gazete në Beograd, Hejko Flottau. Ai ndër të tjera shkruan:

“Demonstratat e studentëve në Prishtinë, qartë kanë shkuar më larg se sa kanë thënë zyrtarët. Sipas të dhënave nga një konferencë shtypi, në



demonstratat e 26 marsit janë plagosur 23 demonstrues dhe 12 pjesëtarë të forcave të rendit. Nga të plagosurit askush nuk është në rrezik për jetën.

Gazetari Flottau e citon Asllan Fazliun të ketë thënë: “këtu kemi të bëjmë me armikun e jashtëm e të brendshëm”. Autori ecën pak nëpër histori ku theks të veçantë i vë shtypjes së shqiptarëve, si thotë autori, nga pasioni, të Aleksandër Rankoviçit deri në vitin 1966.

Edhe për demonstratat e 1 dhe 2 prillit, kjo gazetë shkruan më 3 prill. Shkrimi është botuar me titullin: “Beogradi i shqetësuar për trazirat në Kosovë”. “Përsëri përleshje mes nacionalistëve shqiptarë dhe policisë”, shkruan gazeta dhe njëkohësisht njofton edhe për gjendjen e jashtëzakonshme dhe ndalimin e çdo lloj tubimi, për sulmet që forumet partiake i bëjnë “armikut”, për sulmet që po këto organe ia bëjnë shtypit të jashtëm etj.

Në numrin e datës 4/5 prill, gazeta e boton një shkrim të agjencisë “Rojter” me titull “Gjendja e jashtëzakonshme vazhdon në Kosovë” dhe një shkrim tjetër të korrespondentit Heiko Flottau me titull “Aspektet sociale dhe nacionale”, i cili duke i cituar udhëheqësit shtetërorë dhe partiakë fletë për demonstratat dhe zhvillimet e atyre ditëve në Kosovë, “për sulmet e armiqve të jashtëm e të brendshëm”, për diferencimin që kishte filluar etj. Njëkohësisht flitet edhe për fajësimet që shteti jugosllav ia bën Shqipërisë dhe anasjelltas.

Arthur Meyer, më 2 maj shkruan për kërkesat për më shumë liri shtypi në Jugosllavi. Titulli i shkrimit është: “Ndërgojcë për shtypin pas trazirave në Kosovë”. “Trazirat e rënda në krahinën e Kosovës, mbi të cilat vetëm

informata të paplota ka, në Jugosllavi kanë hapur diskutime të gjera mbi rolin dhe detyrat e masmediave.

Gazetarët jugosllavë flasin për këtë duke thënë se që nga viti 1945 nuk është luftuar kaq fort e kaq hapur shtypi”, -thotë Meyer.

Më 8 maj, gazeta shkruan “Kosova do të spastrohet”, kurse më 1 qershor, duke shkruar për prapavijën e demonstratave në Kosovë, Arthur Meyer thotë se “Kosova si kurrë më parë është fuçi baroti!”. “Të vrarët në demonstratat e mëdha në krahinën e Kosovës ka kohë që janë varrosur dhe ende as Jugosllavia e as bota nuk e dinë se sa kanë qenë”. Në artikull flitet për mbyllje të Universitetit, për kontrollë policore e ushtarake. Dëshmitarët flasin për atmosferën e një qetësie të rejshe” -thotë gazetari.

Derisa edhe në qoshet më të largëta kodrinore të Jugosllavisë bubullon, një luftë e egër eterike ka shpërthyer mes Radio Tiranës dhe radio-transmetuesve jugosllavë. Ka thashetheme se në bjeshkët e Shqipërisë forcat e armatosura janë vënë në gjendje gatishmërie”.

Më 13 qershor njoftohet për dërgimin e më shumë policëve federativë në Kosovë si dhe për përpjekjet e qeverisë federative për ta vënë Kosovën nën kontroll. Korriku, gushti e shtatori, edhe përkundër ndonjë shkrimi a komenti, janë muaj në të cilët ashtu si edhe në gazetën tjerë njoftohet për proceset gjyqësore dhe lajmi me të cilin përfundon seria e shkrimeve për Kosovën dhe shqiptarët; është lajmi për vetëvrasjen e kryeministrit shqiptar, Mehmet Shehu.

Një tjetër gazetë që i është gjetur Kosovës dhe shqiptarëve për krah në fillimin e pranverës së madhe të vitit 1981 e më tutje,

është gazeta e mirënjohur gjermane, e lexuar dhe e cituar aq shpesh nga Radio Tirana, “Frankfurter Allgemeine Zeitung” me korrespondentin e saj nga Vjena, Viktor Meyer. Edhe kjo gazetë, ashtu si pjesa dërmuese e gazetave gjermane, njofton për fillimin e demonstratave të 11 marsit në Kosovë.

Më 4 prill, Viktor Meyer shkruan: “Gjendja në regionin e Kosovës, e banuar kryesisht me shqiptarë, duket se është serioze. Të enjten është shpallur ndalimi i tubimeve publike. Korzoja mbrëmjeve është e zbrazët. Në të patullojnë forca policore e ushtarake, si dhe të ashtuquajturat Forca të Mbrojtjes Territoriale të veshura me mbrojtëse anti-plumb. Në vendbanimin fqinj, Podujevë, kishte kamionë të djegur. Ka pasur shumë të plagosur e të arrestuar. Zyrtarisht flitet se demonstruesit kanë pasur armë me vetë”, - shkruan Meyer.

Ai më tutje shkruan se kur studentët në bisedë me zyrtarët shtetërorë dhe partiakë kërkuar që Kosova të konstituohet në republikë, zyrtarët i ndërprejnë bisedimet dhe konviktet e studentëve u pushtuan nga policia. Sipas autorit, kryetari i Kryesisë së Kosovës, Xhavit Nimani, këto demonstrata i quajti “manifestime armiqësore nga pozitë e nacionalizmit shqiptar. Ai tha se demonstratat janë të nxitura nga armiq të brendshëm dhe të jashtëm dhe si të tilla janë kundërrevolucionare”.

Po në të njëjtin numër dhe në të njëjtën faqe botohet edhe një shkrim për Kosovën me titull: “Inteligjenca e re dhe detyrimi kombëtar”. Më 7 prill, edhe kjo gazetë duke u mbështetur në të dhëna zyrtare, njofton për 11 të vrarë në demonstratat e marsit dhe prillit, si dhe për

demonstrata edhe në qytete tjera të Kosovës.

Më 9 prill Meyer shkruan: “Tirana merr anën e shqiptarëve të Kosovës. Ajo thotë se kërkesat për republikë janë të drejta”. Të njëjtën ditë në këtë gazetë botohet edhe një shkrim nga i njëjti autor me titull “Në Kosovë ka mosbesim të thellë”. Konfliktet në krahinën jugosllave kanë arsye të brendshme”, është një shkrim tjetër i Meyerit.

Edhe më 21 prill, përsëri Viktor Meyer nga Vjena. Ai shkruan se pas trazirave në Kosovë, në radhët e partisë ka nervozë. Ndërkaq, më 27 prill ai thotë: “Për shkak të këtyre ngjarjeve në Kosovë, një pjesë e funksionarëve jugosllavë kanë humbur kokën”. Duke folur për të vrarë e të plagosur, Meyer thotë se “demonstratat në Kosovë ishin më të ashpra dhe me përmasa më të mëdha sesa thuhet zyrtarisht. Njerëz të informuar mirë flasin për 30 deri në 40 të vrarë dhe për më shumë se 1 000 të plagosur, nga të cilët numër i madh nga frika e pasojave shërohen në shtëpi të tyre.

Autori Meyer në fund shkruan: “Sulmet që i bëhen Shqipërisë për nxitje janë më shumë taktike. Udhëheqja e Kosovës, duke e sulmuar Tiranën zyrtare për nxitje të trazirave, përpiqet që të ia lehtësojë pozitën vetvetes”. Gjatë korrikut, gushtit dhe shtatorit, edhe kjo gazetë sjell lajme për proceset gjyqësore, të cilat janë aq të shumta dhe aq absurde.

Kosova dhe shqiptarët kanë qenë shumë të pranishëm edhe në gazeta tjera gjermane qoftë në të përditshmet, qoftë të përkohshmet. Organi i Partisë Komuniste Gjermane “Roter Morgen”, i botoi 16 artikuj gjatë vitit 1981.


Disa nga titujt e artikujve janë:

“Masakrat e trupave të Beogradit në Kosovë”, “Kush nxit përçarje midis popujve të Jugosllavisë?”, “Provokimet jugosllave”, “Çka ndodhi para ambasadës jugosllave në Tiranë?”, “Është e drejtë kërkesa për njohjen e statusit të Republikës së Kosovës”, “Fjalor i hapur i Rankoviçit”, “Trazirat e vitit 1968”, “Lufta e popullit të Kosovës është e drejtë”, “Tani procese masive në Kosovë”.

Edhe gazetën tjerë gjermane: “Der Tages Spiegel”, “Berliner Morgenpost”, “Die Welt”, “Frankfurter Rundschau”, “Süd Kurier”, “Frankfurter Allgemeine” etj, gazetën austriake “Der Standard”, “Die Presse”, “Die Neue Zeit”, “Kurier”, “Neues Volksblatt”, “Tagblatt für Österreich”, “Neue Kronenzeitung”, gazetën zvicerane: “Focus”, “Der Bund”, “Aargauer Tagblatt”, e gazeta tjera, janë gazeta që në faqet e tyre kanë njoftuar për zhvillimet në Kosovë dhe ndër shqiptarë.

Kosova dhe shqiptarët në shtypin zvicerano-gjermano-austriak në vitin 1981 kanë zënë hapësirë të madhe dhe janë paraqitur kryesisht në mënyrë korrekte dhe, edhe nëse ka ndodhur ndonjë gabim, ka ndodhur për shkak të mungesës së informacioneve. Në faqet e këtij shtypi ka pasur lajme të shkurtra, raporte, reportazhe, udhë-përshkrime...!

Edhe kur është shkruar për “nacionalizmin dhe irredentizmin shqiptar”, për armiq të brendshëm e të jashtëm” apo për “kundërrevolucionin”, ato nuk kanë qenë shprehje të atyre gazetave e as të autorëve të tyre. Ato kanë qenë citime dhe si të tilla edhe janë sjellë në artikuj, gjithnjë në thonjëza apo me “sipas...” , “thotë...”, “ka thënë...” etj./ Memorie.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Drita ruan kreun e tabelës në Superligë

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Tri ndeshjet e fundit të javës së 30 në Albi Mall Superligën e Kosovës kanë sjellë fitore të skuadrave të kreut të renditjes. Drita ka realizuar fitore me rezultat bindës 3:0 ndaj Llapit, duke dëshmuar formë të qëndrueshme në fazën vendimtare të kampionatit. Me këtë fitore Drita vazhdon të kryesojë renditjen me 57 pikë, pesë më shumë se ndjekësi më i

afërt, Ballkani. Ky i fundit, po ashtu, ka shënuar fitore me rezultat 3:0, duke e mposhtur Ferizajn, në Suharekë dhe duke mbajtur të hapur garën për titull. Në një tjetër ndeshje të rëndësishme të javës, Malisheva ka arritur një fitore dramatike në udhëtim ndaj Dukagjinit falë golit të Xhemal Ibishit të shënuar në minutën e 93-të. Ky triumf i ka mundur

Malishevës të ngjitet në pozitën e tretë me 46 pikë, duke kaluar Prishtinën dhe Gjiljanin në renditje. Prishtina aktualisht mban vendin e katërt me 45 pikë, ndërsa Gjilani renditet i pesti me 44 pikë. Dukagjini dhe Drenica ndajnë pozitën e mesit të tabelës me nga 38 pikë, ndërsa Llapi dhe Ferizaj mbeten në zonën e rrezikut me nga 33 pikë.



## DYSHIME PËR KURDISJE TË NDESHJEVE, FFK-ja: VAZHDOJMË TA MBROJMË FUQISHËM INTEGRITETIN E GARAVE

**PRISHTINË, 27 PRILL** - Në funksion të transparencës dhe informimit të drejtë të opinionit publik, si dhe në përgjigje të interesimit të medieve lidhur me deklaratat e fundit të disa zyrtarëve të klubeve në rrjete sociale për kurdisje të ndeshjeve, Federata e Futbollit e Kosovës, përkatësisht Komisioni i Integritetit të Garave dhe Komisioni i Garave ka thënë se vazhdojnë ta mbrojnë integritetin e garave. "Federata e Futbollit e Kosovës monitoron në mënyrë të vazhdueshme jo vetëm këtë xhiro, por të gjitha ndeshjet e kampionatit. Paralelisht, ekziston edhe një organizatë e kontraktuar nga UEFA, e cila përmes mekanizmave të saj të specializuar bën monitorimin dhe analizimin e ndeshjeve për çështje që lidhen me integritetin. Brenda FFK-së funksionon Komisioni i Integritetit të Garave, ku për çdo ndeshje angazhohen përfaqësues të këtij komisioni

me qëllim të mbikëqyrjes dhe raportimit të çdo situatë potenciale që mund të cenojë integritetin e garës. Federata e Futbollit e Kosovës është e përkushtuar maksimalisht për ruajtjen e integritetit të garave dhe nuk toleron asnjë formë të manipulimit të ndeshjeve apo ndikimit të paligjshëm në rezultatet sportive", është thënë në reagimin e FFK-së. Lidhur me deklaratat publike të bëra nga zyrtarë të klubeve, FFK-ja ka njoftuar se do t'i trajtojë ato me seriozitet të plotë dhe në përputhje me rregulloret në fuqi. "Do të iniciojë procedura disiplinore përkatëse, dhe sigurisht në bazë të kësaj do të përfshihen për të hetuar rastin edhe institucionet relevante, si Policia e Kosovës dhe organet tjera në kuadër të Këshillit Kombëtar për parandalimin dhe sanksionimin e dhunës dhe dukurive negative në ngjarjet sportive, institucione të cilat

tashmë janë të njoftuara. Po ashtu, FFK-ja është në komunikim të vazhdueshëm me mekanizmat përkatës të UEFA-s, të cilët kanë qenë në dijeni për deklaratat e tilla, ndërsa ndeshjet në fjalë kanë qenë dhe mbeten të monitoruara", është thënë në reagim. Më tutje, FFK-ja ka garantuar se çdo individ apo klub që vërtetohet se është i përfshirë në manipulim të ndeshjeve apo cenim të integritetit të garave do të përballlet me masa të rrepta disiplinore deri në përjashtim nga të gjitha garat. "Megjithatë, ritheksojmë se shpeshherë në opinion qarkullojnë fjalë e deklarata për arsye të ndryshme, me qëllim dëmtimi i imazhit të njërit apo tjetrit klub, por edhe dëmtim të imazhit të përgjithshëm të futbollit të Kosovës, andaj ftojme të gjithë ata që bëjnë pretendime publike që të paraqiten pranë organeve kompetente me fakte dhe



dëshmi konkrete. Vetëm në bazë të provave të qëndrueshme mund të ndërmerren veprime konkrete dhe të garantohen procese të drejta. Federata e Futbollit e Kosovës garanton se çdo individ apo klub që vërtetohet se është i përfshirë në manipulim të ndeshjeve apo cenim të integritetit të garave do të përballlet me masa të rrepta disiplinore, deri në përjashtim nga të gjitha garat, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe rregulloret e FFK-së, si dhe normativat e UEFA-s dhe FIFA-s. Rikujtojmë se të gjitha klubet pretendente për pjesëmarrje në

garat ndërkombëtare janë nën monitorim të vazhdueshëm, duke qenë se UEFA nuk lejon përfshirjen në garat e saj të ekipeve që cenojnë integritetin e ndeshjeve", është thënë në reagimin e FFK-së. FFK-ja ka ftuar gjithashtu çdo person që ka informata të besueshme lidhur me raste të tilla që t'i paraqesë ato pranë organeve kompetente, përfshirë Prokurorinë e Shtetit, teksa me rëndësi të veçantë do të ishin dëshmitë e drejtpërdrejta nga pjesëmarrësit apo aktorët e ndeshjeve. "Federata e Futbollit e Kosovës, së bashku me të gjitha organet e saj, mbetet e përkushtuar maksimalisht për ruajtjen dhe avancimin e integritetit të garave, si dhe për ta çuar futbollin në nivel sa më të lartë, por edhe sa më të drejtë, transparent dhe në përputhje me standardet më të larta ndërkombëtare", është thënë në reagimin e FFK-së.

## KOK-u DHE MSR-ja NËNSHKRUAJNË MEMORANDUM BASHKËPUNIMI



**PRISHTINË, 27 PRILL** - Komiteti Olimpik i Kosovës dhe Ministria për Sport dhe Rini kanë nënshkruar sot memorandum bashkëpunimi për mbështetje financiare të KOK-ut për vitin 2026. Memorandumi është nënshkruar nga ministri Blerim Gashani dhe presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi. Memorandumi parasheh mbështetje financiare në vlerë 1 milion e 150 mijë euro.

Ministri Gashani ka theksuar se kjo është mbështetje e vazhdueshme që këtë herë po fuqizohet edhe më shumë shkaku i aktiviteteve të shumta të KOK-ut, me theks të veçantë Lojërat Mesdhetare Taranto 2026. Presidenti Krasniqi, duke falënderuar ministrin për vizitën dhe memorandumimin, ka deklaruar se kjo mbështetje lehtëson zhvillimin e aktiviteteve

sportive, sidomos pjesëmarrjen me numër të madh të sportistëve në LM Taranto 2026 të cilat i paraprijnë LM Prishtina 2030. Sekretari i përgjithshëm i KOK-ut, Besim Aliti, ka thënë se shuma prej mbi një milion euro është rekord i mbështetjes nga ministria, e kjo tregon një seriozitet institucional dhe partneritet të fuqishëm.

## Arbër Hoxha, kampion i Kroacisë me Dinamo Zagerbin

**ZAGREB, 27 PRILL** - Ylli i Kombëtares së Shqipërisë me prejardhje nga Kosova, Arbër Hoxha, ka arritur një sukses të madh në karrierë, duke u shpallur kampion i HNL me

skuadrën e Dinamo Zagrebit. Titulli është konfirmuar pas ndeshjes së xhiros së 32-të, ku Dinamo Zagrebi ka triumfuar ndaj NK Varazdin me rezultat 2-1. Sa i përket paraqitjes

individuale, Arbër Hoxha është vlerësuar me notën 6.8 nga platformat e statistikave, ndërsa vazhdon të konsiderohet një nga lojtarët e rëndësishëm të skuadrës kroate. 27-vjeçari ka

pasur rol të qëndrueshëm gjatë sezonit, duke kontribuar në suksesin e Dinamo Zagrebit në kampionatin kroat dhe duke konfirmuar vlerën e tij si një nga elementët kyç të ekipit.





## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



[www.facebook.com/gjejpuneshpejite](http://www.facebook.com/gjejpuneshpejite)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553

### NJOFTIM

Njoftojmë të gjithë klientët se Shoqëria me Përgjegjësi të Kufizuar “Fisi Ash Pharm” SH.P.K. pronar Fisnik Çitaku me seli në Prishtinë, ka marrë vendim të shuajë biznesin me nrb. 811482405 dhe ka caktuar likuidatorin për zhvillimin e procedurës së Likuidimit. Njoftohen të gjithë klientët që kanë raporte Kreditorë - Debitorë në këtë korporatë që të paraqiten në afatin 30 ditor nga data e shpalljes në gazetë.

### OBAVESTENJE

Obavestavanje se svi klienti da drustvo sa “Fisi Ash Pharm” D.O.O. Fisnik Çitaku Pristina donelo odluku o prestani rada sa nrb. 811482405 ujedno imenovao Likvidatora o sprovodjenju postupka likfidacije. Obavestavaju se svi klienti koji imaju obaveze i potrazivanja u navedenoj firmi, da se jave u roku od 30 dana od dana objavljivanja o novine.

### ANNOUNCEMENT

We inform al customers that the limited liability “Fisi Ash Pharm” L.L.C. with owner Fisnik Çitaku with headquarters Pristina, has come to the decision to quit its business: 811482405 the company has appointet a liquidator wsho is going to oversee the liquidator process. All clients who have the mortgager – mortgage accounts in this company are kindly request to show up within 30 days starting from the day of newspaper announcement- publication.

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Mimoza Osmani shpall të pavlefshme pasaportën e lëshuar nga Republika e Kosovës.

- Visar Hasimja B.I. shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 811518789 të lëshuar nga ARBK.

- Albina Dinë Berdynaj shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Baçelor i Edukimit Fillor.

- Arta Salihi shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl 1-5 dhe 6-9.

- Salih Imeri shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12. dhe diplomën e gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Veton Muhadri shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë si dhe dëftesat e kl. 10.11.12.

- Beqir Cenaj shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11.12 dhe diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Bedri Smolica shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

- Buna Sada shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të Gjimnazit “Hajdar Dushi” Gjakovë.

Albrim Sylja shpall të pavlefshme dëftesën e plotë të sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Andi Firzi shpall te pavlefshme 3 dëftesat dhe diplomën QK “11 marsi” Prizren.

- Francez Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IX shfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.

- Kristijan Ransi shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IXshfmu “ Zef Lush Marku” Velezhe.

- Mensur Morina shpall të pavlefshme dëftesën e plotë sh.f.m.u. “Selman Riza” Gjakovë nga kl. 1-5 dhe 6-9.

- Kreshnik Berisha B.I. Rogovë Gjakovë shpall të pavlefshme numrin Unik Identifikues: 812216259 të lëshuar nga ARBK.

- Aida Murselaj Çiflak Rahovec shpall të pavlefshme diplomën e Universitetit “Fehmi Agani” Gjakovë me numër 200102037.

- Muharrem Miftari shpall të pavlefshme diplomën e shkollës se mesme “Silvira Tomazini” gjimnazi “Frang Bardhi” Mitrovicë.

**Lume's Details**  
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Abropa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



## ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Në bazë të nenit 57 të Ligjit Nr. 04/L-150 për Odat e Profesionistëve Shendetësor, Nenit 8 të Ligjit Nr. 03/L-212 të Punës, si dhe nenin 5 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ (MFPT) Nr. 01/2024 për Rregullimin e procedurave për themelimin e marrëdhënies së punës në sektorin publik, Oda e Mjekëve të Kosovës shpall këtë:

### KONKURS

#### Për plotësimin e vendit të punës

<b>Titulli i vendit të punës:</b>	Zyrtar Administrativ për Komisionet të Përhershme (1) pozitë
<b>I raporton:</b>	Udhëheqësit të Zyrës për Administratë dhe Financa
<b>Niveli i pagës:</b>	5.78
<b>Orët e Punës:</b>	40 orë në javë
<b>Kohëzgjatja e Kontratës:</b>	Afat i caktuar (1 vit me mundësi vazhdimi)
<b>Vendi Punës:</b>	"Instituti A" QKUK, 10 000 Prishtinë

#### Detyrat e përgjithshme:

- Merr pjesë në mbledhje të organeve të Odës dhe komisioneve të përhershme të Odës me qëllim të ofrimit të asistencës;
- Mbanë evidencën e mbledhjeve të komisioneve të përhershme të Odës dhe organeve të tjera ku kërkohet;
- Siguron materialet e nevojshme për mbarëvajtje të mbledhjeve të komisioneve të përhershme;
- Mbanë dhe përgatit procesverbalet e takimeve;
- Mirëmbanë dosjet e komisioneve të përhershme;
- Ndihmonë anëtarët e komisioneve në kontaktet me organet e tjera të OMK-së si dhe palëve të tjera;
- Kujdeset për zhvillimin e proceseve që ndërlidhen me vendimmarrjen e komisioneve të Odës; dhe
- Kryen dhe punë të tjera nga fusha e përgjegjësisë dhe sipas nevojave të organeve të Odës dhe shërbimit profesional në përgjithësi

#### Kualifikimet:

- Të ketë të përfunduar fakultetin në fushat relevante, niveli bachelor;
- Një (1) vitë përvoj pune në administratë;
- Preferohen kurse dhe trajnime gjatë karrierës profesionale;

#### Aftësitë:

- Aftësi për zbatimin e procedurave dhe udhëzimeve administrative për kryerjen e detyrave të punës;
- Njohje e mirë e punës me kompjuter Word, Excel, Internet dhe mjeteve tjera teknike në zyrë, fotokopjuesi;
- Shkathësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, për të dhënë udhëzime dhe për të përcjellë informata tek të tjerët;
- Të jetë energjik, të ketë iniciativë dhe kreativitet duke ofruar ide të reja në çështje të ndryshme lidhur me procesin e punës;
- Të jetë fleksibil dhe t'u përgjigjet pozitivisht ndryshimeve;
- Njohja e gjuhës angleze konsiderohet përparësi;
- Shkathësi për të punuar në grup, nën presion dhe të dëshmojë fleksibilitet në punë;
- Etikë në punë dhe integritet.

#### Mënyra e aplikimit;

Aplikimi bëhet vetëm në mënyrë elektronike në adresën: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org)

Kandidatët të cilët konkurojnë duhet të shënojnë saktë adresën, numrin e telefonit kontaktues si dhe email adresën. Vetëm kandidatët që plotësojnë kriteret e konkursit do të ftohen në procedura të tjera të rekrutimit.

#### Dokumentet që duhet të bashkëngjiten:

- Aplikacioni i OMK-së [Formulari i aplikimit](#)
- Kopjen e letërnjoftimit;
- Kopjen e diplomës të kërkuar me konkurs të lëshuar nga institucionet arsimore të Republikës së Kosovës. Nëse diploma është fituar jashtë vendit, vërtetimin e nostrifikimit të diplomës së fituar apo aktin që dëshmon se diploma e fituar është në procedurë të nostrifikimit, me kusht që nostrifikimi i diplomës të dorëzohet deri në momentin e nënshkrimit të aktit për emërim në pozitë;
- Kopjet e dëshmisë së punësimit (vërtetim/kontratë) të lëshuar nga institucioni përkatës i punësimit për përvojën e punës, që përcakton pozitën e punës si dhe kohëzgjatjen e angazhimit në atë pozitë. Dëshmisë e punësimit jashtë institucioneve publike duhet të mbështetë së paku njëra nga dëshmitë si në vijim: pasqyra e pagesave në fondin e kursimeve pensionale apo pasqyra e pagesave të obligimeve tatimore në përputhje me legjislacionin tatimor për të ardhurat personal.
- Dëshmitë e trajnimeve profesionale të ndjekura apo trajnimeve që aplikuesi i ka realizuar në cilësinë e trajnuesit.
- Letër rekomandimet.
- Kopjet e dy raporteve të fundit të njëpasnjëshme të vlerësimit të punës.

#### Kalendari i përafërt i procedurës së rekrutimit:

- Konkursi publik është i hapur deri më 12.05.2026;
- Faza e verifikimit paraprak të aplikacioneve deri në 7 ditë;
- Faza e testit me shkrim 10 ditë pas fazës së verifikimit;
- Faza e intervistës deri në 7 ditë pas shpalljes së rezultateve të testit me shkrim;
- Publikimi i rezultateve deri 5 ditë pas vlerësimit të intervistës.

**Shënim:** Aplikacionet që arrijnë pas afatit të përcaktuar në konkurs dhe ato të pakompletuara me dokumentacionin përkatës nuk do të shqyrtohen.

#### Mënyra e vlerësimit dhe kriteret e poentimit;

- Vlerësimi i kandidatëve zhvillohet nëpërmjet testimit me shkrim dhe intervistimit (testim me gojë);
- Testi me shkrim - maksimumi 70 pikë;
- Intervista - maksimumi 20 pikë
- Jetëshkrimi - maksimumi 10 pikë.

Oda e Mjekëve të Kosovës ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë burrë apo grua dhe nga të gjitha komunitetet në Republikën e Kosovës.

Shpallja është e hapur që nga data 27.04.2026 deri më 12.05.2026 në ora 23:59.

Për informata më të hollëshme mund të kontaktoni në nr. tel.: 049/872-300 apo 038/544-872.



## ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS

KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Na osnovu člana 57. Zakona br. 04/L-150 o komorama zdravstvenih radnika, člana 8. Zakona br. 03/L-212 o radu, kao i člana 5. i 7. Administrativnog uputstva (MFRT) br. 01/2024. o regulisanju postupaka za osnivanje radnog odnosa u javnom sektoru, Lekarska komora Kosova raspisuje ovaj:

### KONKURS

#### o popunjavanu radnog mesta

<b>Naslov radnog mesta:</b>	Administrativni službenik/ca za Stalne komisije (1) pozicija
<b>Izveštava:</b>	Rukovodiocu Kancelarije za administraciju i finansije
<b>Nivo plate:</b>	5.78
<b>Radno vreme:</b>	40 sati nedeljno
<b>Trajanje ugovora:</b>	Na određeno vreme (1 godina uz mogućnost produženja)
<b>Radno mesto:</b>	"Institut A" KUCK, 10 000 Priština

#### Opšte dužnosti:

- Učestvuje na sastancima organa Komore i stalnih komisija Komore u cilju pružanja pomoći;
- Vodi evidenciju o sastancima stalnih komisija Komore i drugih organa gde se zahteva;
- Obezbeđuje potrebne materijale za nesmetano odvijanje sastanaka stalnih komisija;
- Vodi i priprema zapisnike sa sastanaka;
- Održava dosijee stalnih komisija;
- Pomaže članovima komisije u kontaktima sa drugim organima LKK-a kao i drugim stranama;
- Brine o razvoju procesa koji se vežu sa odlučivanjem komisija Komore; i
- Obavlja i druge poslove iz oblasti odgovornosti i prema potrebama organa Komore i stručne službe uopšte.

#### Kvalifikacije:

- Da ima završen fakultet u relevantnim oblastima, nivo bachelor;
- Jedna (1) godina radnog iskustva u administraciji;
- Poželjni su kursevi i obuke tokom stručne karijere;

#### Sposobnosti:

- Sposobnost sprovođenja postupaka i administrativnih uputstava za obavljanje radnih dužnosti;
- Dobro poznavanje rada sa računarom Word, Excel, Internet i drugim tehničkim sredstvima u kancelariji, fotokopir aparatom;
- Komunikacijske veštine, uključujući sposobnost tumačenja informacija, da daje uputstva i prosleđuje informacije kod drugih;
- Da bude energičan, da ima inicijativu i kreativnost pružajući nove ideje u raznim pitanjima u vezi sa radnim procesom;
- Da bude fleksibilan i pozitivno odgovori na promene;
- Poznavanje engleskog jezika se smatra prednošću;
- Veština rada u grupi, pod pritiskom i da dokaže fleksibilnost na poslu;
- Etika na poslu i integritet.

#### Način apliciranja:

Apliciranje se vrši samo elektronskim putem na adresu: [info@omk-rks.org](mailto:info@omk-rks.org)

Kandidati koji konkurisu moraju tačno napisati adresu, broj kontakt telefona kao i email adresu. Samo kandidati koji ispunjavaju kriterijume konkursa biće pozvani na dalje postupke zapošljavanja.

#### Dokument koji se trebaju priložiti:

- Aplikacija LKK-a [Formular apliciranja](#)
- Kopija lične karte;
- Kopija diplome zahtevane konkursom izdate od obrazovnih institucija Republike Kosova. Ako je diploma stečena izvan zemlje, potvrda o nostrifikaciji stečene diplome ili akt koji dokazuje da je stečena diploma u postupku nostrifikacije, pod uslovom da se nostrifikacija diplome podnosi do momenta potpisivanja akta za imenovanje na poziciji;
- Kopije dokaza o zaposlenju (potvrda/ugovor) izdate od odgovarajuće institucije za zapošljavanje za radno iskustvo, koje utvrđuju radnu poziciju kao i trajanje angazovanja na toj poziciji. Dokaz o zaposlenju van javnih institucija mora biti potkrepljen najmanje jednim od dokaza kao u nastavku: izveštaj plaćanja u penzijski štedni fond ili izveštaj plaćanja poreskih obaveza u skladu sa zakonodavstvom o porezu na lične prihode.
- Dokaz o pohađanim stručnim obukama ili obukama koje je aplikant realizovao u svojstvu trenera.
- Preporuke
- Kopije iz dva zadnja izveštaja za procent rada

#### Približni kalendar postupka zapošljavanja:

- Javni konkurs je otvoren do dana 12.05.2026;
- Faza prethodne verifikacije aplikacija do 7 dana;
- Faza pismenog testa 10 dana nakon faze verifikacije;
- Faza intervjuja do 7 dana nakon objavljivanja rezultata pismenog testa;
- Objavljivanje rezultata do 5 dana nakon ocenjivanja intervjuja.

**Beleška:** Aplikacije koje pristignu nakon roka utvrđenog u konkursu i one nepotpune sa odgovarajućom dokumentacijom neće se razmatrati.

#### Način ocenjivanja i kriterijumi bodovanja:

- Ocenjivanje kandidata se odvija putem pismenog testiranja i intervjuisanja (usmeno testiranje);
- Pismeni test - maksimalno 70 bodova;
- Intervju - maksimalno 20 bodova;
- Životopis - maksimalno 10 bodova.

Lekarska komora Kosova pruža jednake mogućnosti zapošljavanja za sve državljanke Republike Kosova i pozdravlja aplikacije od sva lica muškog ili ženskog pola i svih zajednica u Republici Kosova.

Oglas je otvoren od dana 27.04.2026 deri më 12.05.2026 u 23:59 časova.

Za detaljnije informacije možete kontaktirati na br. tel.:049/872-300 ili 038/544-872.

**MEKA**  
HALAL FOOD

# TRADITË QË NGA 1992





ROYAL CROWN



## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

**Quality & Sales Award Recipients**  
[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

